

ANALIZË:

QASJA NË
ARSIMIN
E LARTË PËR
**PERSONAT
ME AFTËSI TË
KUFIZUARA**
NË REPUBLIKËN
E MAQEDONISË
SË VERIUT



British Embassy
Skopje



ukaid
ukaid.gov.uk



Република Северна Македонија
МАКЕДОНСКИ ИНВЕСТИЦИОНЕН
РЕПУБЛИКА
МАКЕДОНСКИ ОМБУДСМАН
Republic of North Macedonia
OMBUDSMAN



Отворете
ги прозорците



WFD

ANALIZË:

QASJA NË ARSIMIN E LARTË PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Shkup, dhjetor 2023

Botuesi

Fondacioni për demokraci të Uestminsterit, Republika e Maqedonisë së Veriut

Për botuesin:

Dona Kosturanova, drejtoreshë në vend

Autori

Kristian Lazarev, Shoqata për teknologji asistive "Hapni Dritaret"

Redaktore

Bojana Jovanovska

Bashkëpunëtorë

Ina Xhugumanova

Stefani Spirovskaja

Në bashkëpunim me:

Zyrën e Avokatit të popullit të Republikës së Maqedonisë së Veriut –
Njësia për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe personave me aftësi të kufizuara

Përktheu:

Jetmir Ziba

Dizajni:

KOMA

Viti i botimit:

2023

Ky produkt është përgatitur në kuadër të projektit “Praktiko demokraci” i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet e përfshira në këtë përmbajtje nuk pasqyrojnë gjithmonë mendimet dhe qëndrimet e Qeverisë Britanike.

7
10
12
17

17

21

35

37

55

70

74

85
88

91

122

126

128

PARATHËNIE

HYRJE

METODOLOGJIA

ANALIZA E TË DHËNAVE

Dokumentet ndërkombëtare

Korniza ligjore nacionale

Praktikë krahasuese nga rajoni

Të dhëna nga analiza e pyetësorëve me fakultete

Analiza e gjetjeve nga fokus grupet me studentët me aftësi të kufizuara

Analiza e gjetjeve nga intervistat me organizatat e shoqërisë civile

Analiza e gjetjeve nga këqyrjet në terren

PËRFUNDIME

REKOMANDIME

Shtojca 1:

Pyetësor për mbledhjen e të dhënave nga fakultetet

Shtojca 2:

Lista e fakulteteve që dorëzuan përgjigjet e pyetësorit

Shtojca 3:

Lista e fakulteteve ku është kryer këqyrja në terren e qasshmërisë fizike

Shtojca 4:

Lista e organizatave të intervistuar të shoqërisë civile dhe organizatave të personave me aftësi të kufizuara

PARATHËNIE

Analiza “Qasja në arsimin e lartë për personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut” shqyrton qasjen në arsimin e lartë për personat me aftësi të kufizuara, më konkretisht qasjen fizike të objekteve (fakulteteve) të cilat janë në kuadër të universiteteve shtetërore, qasjen në informacione në një format të qasshëm (literaturë të disponueshme), sigurimin e teknologjisë asistive dhe/ose mbështetje tjetër të individualizuar për studentët me aftësi të kufizuara, si dhe transportin e organizuar deri në dhe nga fakultetet për studentët me aftësi të kufizuara. Për më tepër, analiza shqyrton numrin e studentëve me aftësi të kufizuara në fakultetet shtetërore, si dhe ata që kanë përfunduar studimet deridiplomike, pasdiplomike dhe të doktoraturës.

Përveç faktit se kjo analizë është unike nga punimet e tjera sepse shqyrton të gjitha këto çështje në detaje për herë të parë, ajo synon kryesisht t’i shërbejë Avokatit të popullit për të përgatitur një Raport që do të përmbajë një pasqyrë të situatës dhe rekomandime specifike për hapa të mëtejshëm në drejtim të avancimit të qasjes në arsimin e lartë për personat me aftësi të kufizuara.

Në fakt, Zyra e Avokatit të popullit njohu përpjekjet e përbashkëta me Fondacionin për demokraci të Uestminsterit për një shoqëri më gjithëpërfshirëse për të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara dhe ngriti iniciativën për të përgatitur këtë analizë. Zyra e Avokatit të popullit si partner i WFD-së mori pjesë aktive në përgatitjen e instrumenteve të analizës, dhe gjetjet e saj do të përdoren në punën e saj të mëtejshme që synon përmirësimin e qasjes në arsimin e lartë.

Kjo analizë vetëm na konfirmoi se përmbushja e të drejtave dhe nevojave të studentëve me aftësi të kufizuara dhe avancimi i pozitës së tyre në shoqëri kërkon një përpjekje të vazhdueshme që kërkon përkushtim dhe bashkëpunim kolektiv. Një nga të dhënat kryesore me të cilat institucionet kompetente duhet të njihen dhe të marrin parasysh janë se: pothuajse gjysma e fakulteteve nuk kanë studentë me aftësi të kufizuara ose nuk mbajnë statistika për numrin e studentëve me aftësi të kufizuara, pjesa më e madhe e sallave të ligjeratave, amfiteatrove, mensave, shërbimeve studentore dhe bibliotekave janë me qasje të kufizuar fizike, asnjë fakultet nuk publikon njoftimet, politikat dhe dokumentet e tij në formatin brajl, formatin audio të arritshëm ose shkronjën standarde në një format të rritur, dhe në vetëm 10% të fakulteteve studentët me aftësi të kufizuara mund të marrin formalisht literaturë në format të qasshëm.

Një pjesë kryesore e kësaj analize janë rekomandimet që të gjitha institucionet kompetente duhet ti marrin parasysh nëse duam të krijojmë një shoqëri gjithëpërfshirëse në të cilën të gjithë personat të kenë qasje të barabartë në arsim, duke përfshirë arsimin e lartë.

Përgatitja e kësaj analize mbështetet nga projekti “Praktiko demokraci”, i realizuar nga Fondacioni për demokraci të Uestminsterit dhe i mbështetur nga Ambasada Britanike në Shkup.

Ne shprehim mirënjohjen tonë për autorin e analizës, Kristijan Lazarev, dhe Shoqatën për teknologji asistive “Hapni dritaret”, si dhe zyrën e Avokatit të popullit, të cilët ishin mbështetës gjatë gjithë procesit. Ne gjithashtu shprehim mirënjohjen tonë për Shkollën shtetërore për fëmijë dhe të rinj me shikim të dëmtuar “Dimitar Vlahov” - Shkup, e cila shtypi gjetjet kryesore të kësaj analize në shkrim brajl dhe mundësoi të njëjtat të jenë të qasshme për njerëzit me shikim të dëmtuar.

Shpresojmë që kjo analizë t’u shërbejë institucioneve në krijimin e politikave dhe masave publike të mëposhtme për të mbështetur studentët me aftësi të kufizuara dhe për të kontribuar në mundësimin e një shoqërie të qasshme duke siguruar qasje adekuate në arsimin e lartë për personat me aftësi të kufizuara.

Dona Kosturanova

Drejtoreshë në vend
Fondacioni për demokraci të Uestminsterit

Stefani Spirovska

Menaxhere e programit

Ina Xhugumanova

Koordinatorë e programit

HYRJE

Me nënshkrimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (KDPAK), shteti ka detyrimin të sigurojë qasje në arsimin e lartë për personat me aftësi të kufizuara, pa diskriminim dhe në mënyrë të barabartë me të tjerët. Duke vepruar kështu, ai duhet të përdorë forma të tilla si përshtatje e arsyeshme për personat me aftësi të kufizuara dhe t'i përmbahet standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare të qasjes.

Shoqata për teknologji asistive "Hapni dritaret", me mbështetjen e Fondacionit për demokraci të Uestminsterit (WFD), përmes projektit "Praktiko demokraci", dhe në bashkëpunim me Zyrën e Avokatit të popullit, përgatiti këtë analizë të qasshmërisë së arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut për personat me aftësi të kufizuara.

Analiza hartëzon situatën me qasjen e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, thekson mundësitë dhe fushat në të cilat situata duhet të përmirësohet dhe mbështet punën e Avokatit të popullit, në departamentin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara.

Analiza ofron një pasqyrë të situatës me qasje në arsimin e lartë për personat me aftësi të kufizuara në disa fusha:

- ▶ qasshmëria fizike e objekteve të fakulteteve në kuadër të universiteteve shtetërore,
- ▶ qasje në informacione, literaturë profesionale në një format të qasshëm, sigurim të teknologjisë asistive dhe llojeve të tjera të mbështetjes së individualizuar për studentët me aftësi të kufizuara, dhe
- ▶ transporti i qasshëm në institucionet e arsimit të lartë për studentët me aftësi të kufizuara.

Analiza gjithashtu bën vlerësimin e numrit aktual të studentëve me aftësi të kufizuara në të tre ciklet e studimeve të mostrës hulumtuese. Në fund, janë dhënë rekomandime konkrete për hapa të mëtejshëm nga palët e interesuara në mënyrë që të avancohet qasja e arsimit të lartë për personat me aftësi të kufizuara.

METODOLOGJIA

Për mbledhjen e të dhënave për përgatitjen e kësaj analize u përdorën metoda cilësore dhe sasore. Duke vepruar kështu, u krijuan disa instrumente hulumtuese, ndërsa gjetjet dhe të dhënat e mbledhura janë përmbledhur në kuadër të 10 fushave kryesore:

- ▶ Informacione të përgjithshme;
- ▶ Të dhëna statistikore për numrin e studentëve me aftësi të kufizuara;
- ▶ Lëvizshmëria (mobiliteti) horizontal(e) në kampuse dhe nëpër ndërtesat e fakultetit;
- ▶ Lëvizshmëria vertikale në kampuse dhe në ndërtesat e fakultetit;
- ▶ Qasja në informacione;
- ▶ Qasja në shërbimet administrative;
- ▶ Rreziqet për sigurinë dhe shëndetin;
- ▶ Disponueshmëria e shërbimeve specifike;
- ▶ Transporti i qasshëm dhe
- ▶ Pyetje të tjera.

Për qëllimet e këtij hulumtimi, u përdorën disa instrumente hulumtuese për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave parësore dhe dytësore.

ANALIZA E PËRMBAJTJES

Analiza e përmbajtjes (desk analiza) mbuloi analizën e ligjeve dhe akteve nënligjore përkatëse ndërkombëtare dhe kombëtare, si dhe analizën e statuteve të universiteteve shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në lidhje me angazhimet dhe detyrimet e tyre për të siguruar arsim të qasshëm për studentët me aftësi të kufizuara. Në kuadër të analizës gjithashtu përfshihet një pasqyrë krahasuese të situatës së qasshmërinë e universitetit më të madh shtetëror në Republikën e Kroacisë, si një praktikë pozitive në rajon.

PYETËSORI PËR FAKULTETET, I DEDIKUAR PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE PËR QASSHMËRINË E ARSIMIT TË LARTË PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

I përgatitur në gjuhën maqedonase dhe shqipe, pyetëtori mbuloi gjithsej 72 pyetje dhe nënpyetje të strukturuar, në pjesëm më të madhe me opsione të ofruara të përgjigjeve, me mundësinë e zgjedhjes së 1 ose disa prej përgjigjeve të ofruara. Pyetëtori u hartua në platformën gogl forms (Google Forms) dhe u dërgua në fakultete në mes të majit 2023, i hapur për t'u përfunduar për një muaj të plotë, respektivisht deri më 15 qershor të vitit 2023. Të dhënat e marra prej tij u analizuan duke përdorur mjetin Mikrosoft eksel (Microsoft excel).

FOKUS GRUPET DHE INTERVISTAT **ME STUDENTËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

Si mbështetje në shkrimin e analizës u përdoren gjetjet nga fokus grupet e realizuara me studentët me aftësi të kufizuara, të cilat u zhvilluan online, përmes platformës Zum (Zoom) në gjysmën e parë të qershorit 2023. Një pjesë e transkriptit përfshihet në rezultatet e analizës. U përdorën pyetësorë gjysmë të strukturuar me pyetje reflektuese, duke i lejuar studentët me aftësi të kufizuara të ndajnë përvojat e tyre nga studimi.

INTERVISTA ME PËRFAQËSUES/E TË ORGANIZATAVE **TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE** **ORGANIZATA TË TJERA TË SHOQËRISË CIVILE**

Me qëllim të mbulimit të një fotografie më të gjerë të situatës dhe mundësive të studimit në dispozicion të studentëve me aftësi të kufizuara, u zhvilluan edhe intervista me organizata të personave me aftësi të kufizuara, si dhe organizata të tjera të shoqërisë civile që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar dhe qasjes. Intervistat u zhvilluan përmes platformës zum (Zoom) në gjysmën e parë të qershorit të vitit 2023, dhe disa u zhvilluan përmes platformës gugël forms (Google Forms). Pyetësi për kryerjen e intervistave përbëhej nga 5 pyetje të hapura reflektuese dhe vizionare dhe u zhvilluan me të njëjtin grup të synuar të të anketuarve gjatë të njëjtit muaj.

KËQYRJE NË TERREN

Këqyrja në terren e fakulteteve u bë për të parë fotografinë reale me qasshmërinë fizike të 17 fakulteteve në 4 kampuse. Këqyrja është realizuar në gjysmën e parë të muajit qershor të vitit 2023, nga ekipit "Hapni dritaret", pasi ka marrë miratimin paraprak nga rektorët. Në këto vizita janë bërë matjet dhe vëzhgimi i terrenit. U mbledhën gjithashtu dëshmi fotografike, të mbështetura nga detaje të dimensioneve të sakta dhe parametrave të tjerë të kërkuar.

Gjatë krijimit të instrumenteve hulumtuese, si pikënisje shërbeu zbatimi i këqyrjes të terrenit për qasshmërinë fizike dhe analiza e të dhënave të mbledhura:

1. Rregullorja për mënyrën e sigurimit të hyrjes të pandërprerë, lëvizjes (horizontale dhe vertikale), qëndrimit dhe punës së personave me aftësi të kufizuara deri në dhe në ndërtesa me dedikime publike dhe afariste, ndërtesa me dedikim të banimit me ndërtesa banimi, si dhe ndërtesa me dedikim banesor-afarist dhe
2. Standardet ndërkombëtare ISO për qasshmërinë – ISO 21542:2011 (E).

ASPEKTET E TIKE

Të dhënat e mbledhura përmes metodave dhe instrumenteve të ndryshme nuk përfshijnë informacione personale. Kur citohen dhe ndahen pikëpamjet e studentëve me aftësi të kufizuara ose përfaqësuesve të organizatave që morën pjesë në hulumtim, deklaratat do të anonimizohen. Fotografitë e bashkangjitura nga këqyrja në terren në qasshmërinë fizike nuk përmbajnë asnjë person të njohur.

KUFIZIME TË NJOHURA

Përveç përpjekjeve në krijimin e metodologjisë për të shmangur rreziqet e mundshme në kryerjen e këtij hulumtimi, ekipi nga "Hapni dritaret" ishte i vetëdijshëm për disa kufizime të tilla si: periudha e verës në të cilën u krye hulumtimi, kur një numër i madh i aktorëve kryesorë përdorin pushimet vjetore, përgjigjja e ngadaltë e institucioneve, si dhe mangësi e hulumtimeve të ngjashme ose identike për të krahasuar gjetjet. Një kufizim shtesë ishte zbatimi online i pyetësorit për fakultetet, intervistat dhe grupet e fokusit. Këto kufizime nuk kanë ndikim në rëndësinë e rezultateve të marra dhe rekomandimeve të propozuara.

ANALIZA E TË DHËNAVE

DOKUMENTET NDËRKOMBËTARE

Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (KDKPAK)

Më 5 dhjetor 2011, Republika e Maqedonisë së Veriut ratifikoi Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, të cilën e nënshkruajti më 30 mars të vitit 2007.¹ Ky është instrumenti i parë zyrtar ndërkombëtar që e shqyrton aftësinë e kufizuar përmes prizmës të të drejtave të njeriut dhe mishëron modelin e tij shoqëror.² Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara rregullon deri në një farë mase çështjen e diskriminimit në bazë të aftësisë së kufizuar. Neni 5 i KDKPAK-së ka zbatueshmëri të përgjithshme (horizontale) që lejon interpretimin e të gjitha dispozitave të KDKPAK-së të shihet përmes prizmës të mosdiskriminimit dhe barazisë së personave me aftësi të kufizuara. Për këto arsye, shtetet palë kanë detyrimin të sigurojnë zbatimin e parimit të dizajnit universal dhe përshtatjen e duhur.

- 1 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë (2011, 5 dhjetor). Ligji për ratifikimin e Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe Protokollin fakultativ ndaj Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. "Gazeta zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut". numër 172 të datës 14 dhjetor, të vitit 2011.
- 2 Modeli social i sheh personat me aftësi të kufizuara si subjekte me të drejtat e tyre, jo si objekte, dhe për këtë arsye thekson respektimin e tyre e drejtave të tyre në mënyrë të barabartë me personat e tjerë në shoqëri. Ai fokusohet në barrierat në shoqëri dhe mjedis, të cilat mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri në mënyrë të barabartë me të tjerët, dhe jo mbi pamundësinë individuale, respektivisht aftësinë e kufizuar per se.". Shiko më shumë në: Popovska Zh. (2018). Interpretues i Konventës ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara të Kombeve të Bashkuara. Në dispozicion në: https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/tolkuvac-un_konvencija.pdf

Me rëndësi të veçantë për këtë analizë është neni 24 i KDPAK-së, i cili garanton të drejtën e arsimimit të personave me aftësi të kufizuara dhe hedh themelet për një ndryshim thelbësor në qasjen në arsim, si dhe neni 9 i KDPAK-së, i cili parashikon që personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të kenë qasje në të gjitha aspektet e shoqërisë në mënyrë të barabartë me të tjerët, duke përfshirë mjedisin fizik, transportin, informacionin dhe komunikimet, si dhe lehtësira dhe shërbime të tjera që i ofrohen publikut.

Neni 24 thekson rëndësinë e sigurimit të mundësive të barabarta arsimore për personat me aftësi të kufizuara pa asnjë formë diskriminimi. Në këtë vizion të **arsimit gjithëpërfshirës**, çdo person, pavarësisht nga aftësia, duhet të ketë mundësinë të arrijë potencialin e tij të plotë, duke mbështetur dinjitetin, vetë-respektin dhe respektin për të drejtat e njeriut.

Konventa përcakton disa objektiva kryesore për **një sistem gjithëpërfshirës të arsimit të lartë**. Dokumenti parashikon një hapësirë ku personat me aftësi të kufizuara mund të zhvillojnë identitetet e tyre unike, të tregojnë kreativitetin e tyre dhe të shfrytëzojnë sa më shumë aftësitë e tyre.

Për të **tejkalar pengesat e përfshirjes**, shtetet nënshkruese, duke përfshirë edhe shtetin tonë, janë të detyruara të marrin masa konkrete. Praktikrat diskriminuese që ndalojnë personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në sistemin e arsimit të përgjithshëm, veçanërisht në arsimin fillor dhe të mesëm të detyrueshëm dhe falas, duhet të hiqen. Për më tepër, është e nevojshme të sigurohet që individët me aftësi të kufizuara të kenë qasje në arsimin fillor dhe të mesëm gjithëpërfshirës, cilësor dhe falas në kushte të barabarta me bashkëmoshatarët e tyre në komunitet.

Një aspekt thelbësor i arsimit të lartë gjithëpërfshirës është **përshtatja e procesit arsimor me nevojat individuale**, respektivisht ofrimi i mbështetjes së nevojshme për të mundësuar mësim të lehtë dhe efektiv për personat me aftësi të kufizuara. Prandaj, përshtatja e strategjive arsimore me stile të ndryshme të të nxënimit mundëson zhvillim akademik dhe social për personat me aftësi të kufizuara.

Qasshmëria fizike luan një rol kyç në krijimin e arsimit të lartë gjithëpërfshirës. Zbatimi i masave për të përmirësuar **qasshmërinë fizike** të institucioneve arsimore, të tilla si sigurimi i shtigjeve të qasjes, rampave, ashensorëve dhe përshtatjeve të tjera, është imperativ. Në këtë mënyrë krijohet një mjedis gjithëpërfshirës që u mundëson studentëve me aftësi të kufizuara të kenë qasje të përshtatshme në procesin e arsimit të lartë.³

Arsimi i lartë gjithëpërfshirës duhet të përfshijë sigurimin e asistentëve dhe mësuesve/profesorëve të cilët mund të ofrojnë **mbështetje individuale për personat me aftësi të kufizuara**, duke përdorur mjetet dhe formatet e duhura të komunikimit, teknikat arsimore dhe materialet për të mbështetur këta persona. Bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin është po aq i rëndësishëm, duke nxitur një sistem mbështetës që mbështet potencialin e personave me aftësi të kufizuara.

3 Neni 24 i Preambulës së Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

Konventa mbron një të ardhme më gjithëpërfshirëse për personat me aftësi të kufizuara në qasjen e tyre në arsimin e lartë. Duke pranuar parimet e saj, vendi ynë ka detyrimin të ndërmarrë hapa dhe masa që do të nënkuptonin sigurimin e qasjes në arsimin e lartë për personat me aftësi të kufizuara në mënyrë të barabartë me të tjerët. Megjithatë, sipas gjetjeve në këtë analizë, vendi ynë ende ka sfida të shumta për të ofruar arsim të lartë gjithëpërfshirës, i cili kërkon një përpjekje të vazhdueshme që kërkon angazhim dhe bashkëpunim kolektiv.

Komiteti për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (në tekstin e mëtejshëm: Komiteti) me komentin e përgjithshëm numër 4 për të drejtën e arsimit gjithëpërfshirës⁴, neni 24 i KDPAK-së, konsideron se pavarësisht progresit të deritanishëm, ka ende sfida serioze, duke pasur parasysh se miliona persona me aftësi të kufizuara kanë të drejtën e tyre për arsim të kufizuar. Në kuadër të ofrimit të arsimit gjithëpërfshirës, sipas komentit të përgjithshëm nr. 4 të Komitetit, konsiderohet përshtatja e të gjitha mjediseve arsimore formale dhe joformale me nevojat dhe kërkesat e ndryshme të personave individualë, si dhe heqja e të gjitha barrierave që e përjashtojnë këtë mundësi. Gjithëpërfshirja përfshin qasjen dhe avancimin në arsimin formal dhe joformal pa diskriminim.⁵

4 Koment i përgjithshëm nr 4 i Komitetit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Në dispozicion në: <https://www.ohchr.org/en/documents/general-comments-and-recommendations/general-comment-no-4-article-24-right-inclusive>

5 Ibid.

KORNIZA LIGJORE NACIONALE

Kjo pjesë e analizës do të shqyrtojë Kushtetutën, si akti më i lartë juridik në vend, si dhe ligjet dhe aktet nënligjore vendase që garantojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara siç janë ato që përcaktojnë standardet për ndërtimin e objekteve, përfshirë fakultetet, parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, të drejtat e mbrojtjes sociale, statutet e fakulteteve, etj.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut u garanton qytetarëve të vendit barazi në liri dhe të drejta pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja kombëtare dhe sociale, bindjet politike dhe fetare, prona dhe statusi shoqëror. Qytetarët janë të barabartë para Kushtetutës dhe para ligjeve⁶ dhe Republika ofron mbrojtje të veçantë për personat me aftësi të kufizuara dhe kushte për përfshirjen e tyre në jetën shoqërore.⁷

⁶ Kuvendi i Republikës së Maqedonisë (1991, 17 nëntor). Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë. E shpallur me vendimin numër 08-4642/1. Neni 9

⁷ Ibid.

Duke vepruar kështu, dispozita nënkupton marrjen e masave afirmative, me qëllim arritjen e barazisë formale, si kategori e garantuar me kushtetutë.⁸

Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi

Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi përkufizon një person me aftësi të kufizuara si një person që ka aftësi të kufizuara fizike, intelektuale, mendore ose shqisore afatgjata, të cilat në bashkëveprim me barriera të ndryshme sociale mund të parandalojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në mënyrë të barabartë me të tjerët.⁹ Ky ligj përfshin në mënyrë eksplicite personat me aftësi të kufizuara në fushën e gjerë të mbrojtjes dhe listën e pashtershme të arsyeve të diskriminimit.

Ligji zbatohet për të gjithë personat fizik dhe juridik dhe zbatohet nga të gjitha organet shtetërore, organet e njësisive të vetëqeverisjes vendore, personat juridik me autorizime publike dhe të gjithë personat e tjerë juridik dhe fizik në të gjithë sektorët dhe fushat. Duke vepruar kështu, ndalohen të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, thirrjen, nxitjen dhe udhëzimin për diskriminim, ngacmim, viktimizim dhe segregacion.

8 Koçoska, E. dhe të tjerë (2017). Analiza e gjendjes së personave me aftësi të kufizuara fizike në Republikën e Maqedonisë. Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut Në dispozicion në: [https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/05/Analiza e gjendjes së personaveme aftësi të kufizuara fizike në Republikën e Maqedonisë.pdf](https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/05/Analiza_e_gjendjes_së_personaveme_aftësi_të_kufizuara_fizike_në_Republikën_e_Maqedonisë.pdf)

9 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut (2020, 30 tetor). Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 258/20 i 30 tetorit 2020.

Si formë më e rëndë e diskriminimit, Ligji konsideron diskriminimin e shumëfishtë, diskriminimin interseksional, diskriminimin e përsëritur dhe diskriminimin e vazhduar. Ligji përkufizon gjithashtu përshtatjen e duhur si të nevojshëm dhe të përshtatshëm që kërkohet në një rast të veçantë, i cili nuk shkakton një barrë joproporcionale ose të panevojshme, për të siguruar gëzimin ose ushtrimin e të gjitha të drejtave dhe lirive të njeriut të personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë të barabartë me të tjerët. Ligji parashikon se pamundësimi i përshtatjes së duhur përbën diskriminim.

Ligji për arsimin e lartë

Në përpjekjen për të krijuar një sistem gjithëpërfshirës të arsimit të lartë, Ligji për arsimin e lartë në vendin tonë përfshin dispozita të ndryshme që mbrojnë të drejtat dhe qasjen e studentëve me aftësi të kufizuara. Në nenin 2 në paragrafet 19 dhe 30 dallohen përkufizimet e “pjesëmarrjes” dhe “shkollimit”, me vëmendje të veçantë për studentët e regjistruar në institucionet publike të arsimit të lartë të financuara nga Qeveria.

Ligji kërkon të sigurojë trajtim të barabartë, duke përfshirë kategoritë e caktuara të studentëve, si ata pa prindër, të verbërit, të shurdhërit, personat me aftësi të kufizuara të grupit të parë dhe të dytë, nënat me fëmijë të vegjël dhe personat e shtruar në spital, nga pjesëmarrja dhe sigurimi i kushteve të veçanta të nevojshme. Neni 43, paragrafi 10, autorizon Këshillin nacional të propozojë një dekret i cili i referohet lirimit të studentëve me aftësi të kufizuara nga kompensimet për studim.

Në mënyrë të ngjashme, neni 94 i detyron universitetet të miratojnë programe që ofrojnë teknologji dhe përshtatin hapësira për të mundësuar qasje të barabartë në arsimin e lartë për personat me aftësi të kufizuara.

Neni 128 i ligjit rendit rastet kur institucionet publike të arsimit të lartë nuk arkëtojnë participim. Kjo përfshin dispozitat për lirim nga participimi për personat pa prindër, invalidët ushtarakë dhe personat me aftësi të kufizuara, siç përcaktohet në një dekret qeveritar. Masa të tilla sigurojnë heqjen e barrierave financiare, duke mundësuar mundësi të barabarta për të gjithë.

Neni 149 rregullon procedurën e regjistrimit të studentëve dhe thekson transparencën dhe trajtimin e barabartë për të gjithë kandidatët, pa diskriminim në bazë të racës, gjinisë, fesë, aftësisë së kufizuar dhe orientimit seksual.

Përveç përpjekjes së Ligjit për arsimin e lartë për vendosjen e standardeve që duhet të respektohen nga institucionet e arsimit të lartë, ka ende hapësirë për përmirësimin dhe përsosjen e tij të rregullave dhe detyrimeve që duhet të respektohen dhe përmbushen, në mënyrë që të sigurohet qasje e përshtatshme për studentët me aftësi të kufizuara dhe të krijohet një mjedis më gjithëpërfshirës për studimin e tyre.

Në fakt, përparimi më i madh në shtetin tonë sa i përket arsimit gjithëpërfshirës vërehet me reformën e arsimit fillor. Miratimi i Ligjit të ri për arsimin fillor është hapi i parë që duhet të mundësojë arsim gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara deri në vitin 2023. Ligji për arsimin e mesëm (LAM), Ligji për arsimin e lartë (LAL), si dhe Strategjia nacionale për arsim 2018-2025, nuk bazohen në një qasje të tërësishme dhe gjithëpërfshirëse dhe për këtë arsye nuk janë në përputhje me KDPAK-së. Për

më tepër, programet arsimore nuk përmbajnë dispozita që do të përshkruanin format e detyrueshme ose të dëshirueshme të qasjes. Megjithatë, megjithëse shteti ynë ka ndërmarrë hapa të caktuar për të futur gjithëpërfshirjen në arsim, rregullati ligjore nuk parashikon përdorimin e gjuhës së shenjave dhe shkrimit brajl në institucionet arsimore, gjë që sjell përfshirje jo të plotë në arsimin fillor.¹⁰

Ligji për ndërtim

Ligji për ndërtim, i cili rregullon rregullat dhe kriteret themelore për ndërtimin e objekteve, në nenin 11 parashikon hyrje dhe lëvizje të papenguar deri në dhe në ndërtim, më saktësisht se ndërtesat me dedikime publike dhe afariste, ndërtesat me dedikim banimi, si dhe ndërtesat me dedikime banimi dhe afariste, duhet të projektohen dhe ndërtohen në mënyrë që personave me aftësi të kufizuara t'u mundësohet qasja, lëvizja, qëndrimi dhe puna e papenguar deri në dhe në ndërtim.¹¹

Me miratimin e ndryshimeve ligjore me qëllim sigurimin e qasshmërisë, pronarët e objekteve të ndërtuara me dedikim publik dhe afarist u detyruan të plotësojnë kushtet për qasje të papenguar të personave me aftësi të kufizuara të parashikuara

10 Analiza e gjendjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut – 2021 në dispozicion në: <https://www.unicef.org/northmacedonia/media/11711/file/mkd-unprd-sitan-mk-2022.pdf>

11 Ligji për ndërtim ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 130/2009, 124/10, 18/11, 36/11, 54/11, 13/12, 144/12, 25/13, 79/13, 137/13, 163/13, 27/14, 28/14, 42/14, 115/14, 149/14, 187/14, 44/15, 129/15, 217/15, 226/15, 279/20 30/16, 31/16, 39/16, 71/16, 132/16, 35/18, 64/18 dhe 168/18 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 244/19 dhe 18/20)

me ligj, jo më vonë se deri më vitin 2015, dhe shkallët në hapësirën e jashtme të destinuara për përdorim publik, në afat prej dy viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, më saktësisht në vitin 2011.

Rregullorja për planifikimin urbanistik

Rregullorja për planifikimin urbanistik përcakton standardet dhe normat për planifikimin urbanistik dhe përcakton principet, parimet dhe metodat për planifikimin racional të vendbanimeve dhe ndërtesave të qëndrueshme për rregullimin dhe përdorimin e hapësirës, metodat dhe teknikat e planifikimit urbanistik, veprimin ligjor të dispozitave të planifikimit, sistemin e klasave të dedikimeve, si dhe çdo standard mbrojtës ose gjenerues që siguron përmbushjen e objektivave dhe parimeve të planifikimit urbanistik.¹² Standardet dhe normat për planifikimin urbanistik të parashikuara në këtë Rregullore sigurojnë kapërcimin e barrierave urbane për personat me aftësi të kufizuara dhe sigurojnë qasje funksionale dhe lëvizshmëri respektivisht mobilitet midis ndërtesave dhe zonave në dhe midis vendbanimeve të të gjithë qytetarëve, veçanërisht personave me lëvizshmëri të zvogëluar ose të vështirësuar, fëmijëve, të moshuarve dhe të tjerëve.¹³

Rregullorja përcakton personat me aftësi të kufizuara si persona me lëndime ose çrregullime të përhershme ose të përkohshme trupore, mendore dhe/ose shqisore, ndaj të cilave barrierat urbane dhe arkitektonike zvogëlojnë ose çaktivizojnë

12 Neni 1, Rregullorja për planifikimin urbanistik

13 Neni 3, Rregullorja për planifikimin urbanistik

lëvizshmërinë, qasjen në ndërtesa dhe zona, dhe kështu pjesëmarrjen në shoqëri në mënyrë të barabartë dhe ushtrimin e të drejtave themelore të njeriut.¹⁴ Për më tepër, Rregullorja parashikon që zhvillimi, miratimi dhe zbatimi i planeve urbanistike duhet të sigurojë tejkalimin e barrierave urbane dhe të sigurojë qasjen funksionale dhe lëvizshmërinë e tokës për përdorim të përgjithshëm, hapësirat publike, deri në dhe në ndërtesa dhe zona brenda dhe jashtë vendbanimeve për të gjithë qytetarët, dhe në veçanti për personat me invaliditet dhe personat me lëvizshmëri të kufizuar.¹⁵

Rregullorja për mënyrën e sigurimit të qasjes të pandërprerë, lëvizjes (horizontale dhe vertikale), qëndrimit dhe punës së personave me aftësi të kufizuara deri në dhe në ndërtesa me dedikime publike dhe afariste, ndërtesa me dedikim të banimit me ndërtesa banesore, si dhe ndërtesa me dedikim banesor-afarist

Kjo Rregullore parashikon që qasshmëria, avancimi i qasshmërisë dhe përshtatja e thjeshtë e ndërtesave do të sigurohet duke projektuar dhe realizuar ato ndërtesa në një mënyrë që përmban elemente të qasshmërisë dhe/ose plotëson kushtet për përdorimin e pajisjeve ndihmëse të përdorura nga personat me aftësi të kufizuara në mënyrën dhe në rastet e përshkruara nga kjo Rregullore.

¹⁴ Neni 188 paragrafi 2, Rregullore për planifikimin urbanistik

¹⁵ Neni 188 paragrafi 1, Rregullorja për planifikimin urbanistik

Rregullorja përkufizon personat me aftësi të kufizuara si persona me aftësi të kufizuara intelektuale dhe fizike pavarësisht nga mosha, respektivisht persona me lëndime trupore që përdorin pajisje të caktuara ndihmëse, persona të verbër dhe me shikim të dëmtuar, persona të shurdhër dhe me dëgjim të dëmtuar, persona me retardim mendor, persona me aftësi të kufizuara në zë, të folur dhe gjuhë, persona autikë, persona të sëmurë kronikë dhe persona me lloje të shumta të aftësive të kufizuara.¹⁶

Rregullorja përcakton në mënyrë të detajuar të gjitha standardet që duhet të respektohen gjatë ndërtimit të ndërtesave me dedikime publike dhe afariste, ndërtesave me dedikime banimi në ndërtesa banesore, si dhe ndërtesave me dedikim banimi dhe afarist, duke përfshirë objektet e arsimit parashkollor dhe shkollor: kopshtet për fëmijë, shkollën fillore dhe të mesme, institucionin e arsimit për personat e rritur, fakultetin, konviktin e nxënësve/studentëve me të paktën 25 dhoma me njësi sanitare të përbashkëta, konviktin e nxënësve/studentëve të llojit hotel (dhomë/TWC) me të paktën 25, lagjet e apartamenteve të studentëve me të paktën 25 apartamente, etj.¹⁷

16 Neni 4, Rregullorja për mënyrën e sigurimit të qasjes të pandërprerë, lëvizjes (horizontale dhe vertikale), qëndrimit dhe punës së personave me aftësi të kufizuara deri në dhe në ndërtesa me dedikime publike dhe afariste, ndërtesa me dedikim të banimit me ndërtesa banimi, si dhe ndërtesa me dedikim banesor-afarist

17 Neni 5, Rregullorja për mënyrën e sigurimit të qasjes të pandërprerë, lëvizjes (horizontale dhe vertikale), qëndrimit dhe punës së personave me aftësi të kufizuara deri në dhe në ndërtesa me dedikime publike dhe afariste, ndërtesa me dedikim të banimit me ndërtesa banesore, si dhe ndërtesa me dedikim banesor-afarist

Statutet e universiteteve në RMV

Për qëllimet e kësaj analize, ishin analizuar statutet e: Universitetit “Goce Delçev” - Shtip¹⁸, Universiteti “Shën. Kirili dhe Metodi” - Shkup¹⁹, Universiteti “Shën. Klimenti i Ohrit” - Manastir²⁰, Universiteti “Nënë Tereza” - Shkup²¹, Universiteti “Shën. Apostull Pali” - Ohër²² dhe në Universitetin e “Tetovës” - Tetovë²³.

Të gjitha këto statute përmbajnë dispozita që parashikojnë qasje të barabartë në arsimin e lartë dhe të drejtat e studentëve. Ato parashikojnë mundësinë që studentët të kenë të drejtë për periudha shtesë për provime, veçanërisht studentët me nevoja specifike, siç janë ata pa prindër ose me aftësi të kufizuara. Për më tepër, statutet theksojnë mbrojtjen nga diskriminimi në bazë të faktorëve të ndryshëm si raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, etj., duke promovuar mundësi të barabarta për të gjithë studentët.

-
- 18 Statuti i Universitetit Goce Delçev – Shtip, shih më shumë në: https://www.ugd.edu.mk/documents/ugd/statut_na_UGD.pdf
 - 19 Statuti i Universitetit “Shën. Kiril dhe Metodi në Shkup, shih më shumë në: https://www.ukim.edu.mk/dokumenti_m/264_STATUT_UKIM-6.6.2019.pdf
 - 20 Statuti i Universitetit “Shën. Kliment i Ohrit” në Manastir, shih më shumë në: <https://uklo.edu.mk/wp-content/uploads/2020/10/Statut-na-Univerzitetot-Kliment-Ohridski-Bitola.pdf>
 - 21 Statuti i Universitetit “Nënë Tereza në Shkup, shih më shumë në: <https://unt.edu.mk/wp-content/uploads/2016/12/Buletini-nr.10-05.04.2018.pdf>
 - 22 Statuti i Universitetit “Shën. Apostull Pali” në Ohër, shihni më shumë në: <https://rb.gy/s1ydm0>
 - 23 Statuti i Universitetit të “Tetovës” në Tetovë, shih më shumë në: https://drive.google.com/file/d/1YW-pSjMzIHMYp_NknkXsyosvfKDFC7/view

Për më tepër, ato sigurojnë mekanizma për mbrojtje nga diskriminimi dhe mbështetje për studentët me aftësi të kufizuara duke avancuar infrastrukturën, fakultetet dhe përshtatjen e tyre përkatëse.

Në përgjithësi, statutet e universiteteve janë të ngjashme. Megjithëse ato në përgjithësi rregullojnë ndalimin e diskriminimit dhe mundësinë e afateve shtesë për dhënien e testeve për një kategori të caktuar të studentëve, ajo që mungon është rregullimi i detajuar i përshtatjes përkatëse që është e nevojshme në fakultete dhe mënyrat në të cilat ata mund ta bëjnë atë, nevoja për të ofruar shërbime mbështetëse për studentët me aftësi të kufizuara sipas nevojave të tyre individuale, sigurimi i literaturës profesionale në një format të qasshëm, përdorimi i gjuhës së shenjave, shkrimit brajl, teknologjisë asistive, dhe të ngjashme. Vetëm një nga universitetet devijon nga ajo që parashikon Ligji për arsimin e lartë dhe në statutin e tij parashikon sigurimin e qasjes fizike për studentët e tij në kuadër të mundësive, që është një shembull pozitiv për universitetet e tjera.

Dekret për të drejtën e personave me aftësi të kufizuara dhe personave të tjerë për t'u liruar nga participimi për studim

Dekreti i miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për lirim nga pagesa e participimit për studentët me aftësi të kufizuara dhe personat e tjerë synon të lehtësojë barrën financiare për studimin e personave me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit të lartë. Sipas Dekretit, person me aftësi të kufizuara konsiderohet personi që ka çrregullime afatgjata trupore, intelektuale, mendore ose shqisore që në bashkëveprim me aftësi të kufizuara të ndryshme mund të parandalojnë pjesëmarrjen e tij të plotë dhe efektive në shoqëri në mënyrë të barabartë me të tjerët. Kur dorëzoni kërkesën për lirim nga participimi për studime, është e nevojshme të paraqisni një gjetje dhe mendim nga Shërbimi për vlerësimin funksional në institucionin e shëndetit publik Shtëpia e shëndetit Shkup ose nga një organ profesional për llojin dhe shkallën e aftësisë së kufizuar dhe nevojat e veçanta të personit me aftësi të kufizuara.²⁴

Deri në korrik të vitit 2023, personat me aftësi të kufizuara të regjistruar në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, arsimit të cilëve financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, u liruan nga participimi për studim. Kjo do të thoshte që të gjithë studentët me aftësi të kufizuara që kanë përmbushur kushtet kishin të drejtë të studionin pa pagesë dhe nuk u kërkohej të paguanin

²⁴ Neni 2, Dekreti për të drejtën e personave me aftësi të kufizuara dhe personave të tjerë për t'u liruar nga participimi për studim

participim.²⁵ Me ndryshimin e dekretit të miratuar në korrik të vitit 2023, vetëm studentët e ciklit të parë të studimeve janë të liruar nga pagesa e participimit për studim.²⁶

Rregullore për mënyrën dhe vëllimin e shërbimeve sociale, normat dhe standardet për ofrimin e shërbimeve sociale për asistencë personale

Kjo Rregullore miratohet nga ministri i punës dhe politikës sociale dhe synon të përcaktojë kushtet dhe fushëveprimin e shërbimit të asistencës personale, i cili lejon personat me aftësi të kufizuara të marrin ndihmën dhe mbështetjen e nevojshme për pjesëmarrje të pavarur dhe të barabartë në komunitet dhe kryerjen e aktiviteteve të përditshme.

Asistenca personale ofrohet nëpërmjet qendrave të punës sociale që mbulojnë edhe shpenzimet e këtij shërbimi. Më konkretisht, shërbimi i asistencës personale ofrohet nga dhënës të licencuar ose të autorizuar të shërbimeve sociale, përkatësisht persona fizik që kryejnë punë në mbrojtjen sociale si veprimtari profesionale në përputhje me Ligjin për mbrojtje sociale.

Me ndryshimet në Ligjin për mbrojtje sociale, ndihma dhe mbështetja individuale u ofrohet personave nga mosha 6 vjeç dhe të rriturve me kapacitet të zvogëluar funksional.

25 Neni 3, Dekreti për të drejtën e personave me invaliditet dhe personave të tjerë për t'u liruar nga participimi për studim

26 Neni 1, Dekreti për të drejtën e personave me invaliditet dhe personave të tjerë për t'u liruar nga participimi për studim

Qëllimi kryesor i këtij shërbimi është t'u mundësojë individëve të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të mëvetësishme, si dhe pjesëmarrjen e tyre aktive dhe të barabartë në komunitet.²⁷

Personat që mund të jenë përdorues të shërbimit të asistencës respektivisht ndihmës personale janë personat me aftësi të kufizuara fizike të rënda dhe më të rënda, si dhe personat plotësisht të verbër. Kjo përfshin personat që kanë kapacitet funksional të zvogëluar në mënyrë të konsideruar dhe kanë nevojë për ndihmë dhe mbështetje intensive për të kryer aktivitetet e përditshme.²⁸ Kohëzgjatja e përgjithshme e shërbimit mund të jetë deri në 80 orë në muaj. Këto orë përdoren për të ofruar ndihmë dhe mbështetje individuale në një sërë situatash të ndryshme, duke përfshirë aktivitetet themelore dhe instrumentale të jetës së përditshme në shtëpinë e përdoruesit, vendin e punës, institucionet arsimore, qendrat e rehabilitimit dhe vende të tjera ku përdoruesi ka nevojë për ndihmë. Këto orë mund të përdoren gjithashtu për aktivitete që janë me interes për vetë personin.²⁹

Megjithëse kjo Rregullore lehtëson lëvizjen dhe funksionimin e përditshëm të personave me aftësi të kufizuara, me ndihmën e asistencës personale, KDPAK-së përpiqet për pavarësi dhe autonomi të plotë të personave me aftësi të kufizuara, dhe mbështetja nga një palë e tretë, respektivisht nga asistentët,

27 Ligji për ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen sociale, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 163, datë 16.7.2021

28 Neni 3, Rregullore për mënyrën dhe vëllimin e shërbimeve sociale, normat dhe standardet për dhënien e shërbimeve sociale për asistencë personale

29 Neni 4, Rregullore për mënyrën dhe vëllimin e shërbimeve sociale, normat dhe standardet për dhënien e shërbimeve sociale për asistencë personale

duhet të konsiderohet si një opzion i fundit. Për shkak të shkallës së lartë të paqasshmërisë në shoqërinë tonë, tani për tani ky opzion duket të jetë më i përshtatshmi për personat me aftësi të kufizuara, funksionimi i të cilëve është më së shumti i varur nga palët e treta.

Programi për përdorimin e privilegjuar të transportit publik urban³⁰

Programi për përdorimin e privilegjuar të transportit publik urban miratohet nga Qyteti i Shkupit dhe i referohet sigurimit të biletave falas për studentët me aftësi të kufizuara dhe shoqëruesit ose asistentët e tyre, por është i kufizuar vetëm në kuadër të Qytetit të Shkupit. Iniciativa e Qytetit të Shkupit është të sigurojë që personat me shikim të dëmtuar, me dëgjim të dëmtuar, me dëmtim fizik, personat me aftësi të kufizuara të moderuara dhe të rënda intelektuale, personat me aftësi të kufizuara të kombinuara zhvillimore, personat me spektër të sjelljes autike, personat me aftësi të kufizuara të lehta intelektuale deri në moshën 26 vjeç, personat e sëmurë me veshkët nën trajtimin e hemodializës, si dhe personat e moshuar dhe të pamundur në Shtëpinë "Nënë Tereza" për të moshuarit marrin një biletë vjetore falas për transportin publik urban, për të cilën ata duhet të plotësojnë kushte dhe kritere të caktuara.

30 Analiza e këtij programi bazohet në programin e fundit në dispozicion të publikut për përdorimin e privilegjuar të transportit publik urban nga viti 2021, i cili ndërkohë mund të ketë pësuar ndryshime të caktuara.

Personat që kanë nevojë për mbështetje mund të përfitojnë një biletë vjetore pa pagesë për transportin publik urban dhe për asistentët/shoqëruesit e tyre, me një konstatim dhe mendim të lëshuar nga një organ kompetent që deklaron se ata kanë nevojë për shoqërim ose ndihmë nga një person tjetër.

PRAKTIKË KRAHASUESE NGA RAJONI

Përveç sfidave të caktuara që ende ekzistojnë, Republika e Kroacisë, më konkretisht Universiteti i Zagrebit, mund të dallohet si një praktikë pozitive në rajon, pasi ka bërë një hap të rëndësishëm në avancimin e të drejtave të studentëve me aftësi të kufizuara. Në fakt, universiteti ofron mbështetje për studentët me aftësi të kufizuara dhe ata që kanë vështirësi në të mësuar, duke ofruar teknologji asistive: shkrimin brajl, zmadhues elektronikë, skanerë të dorës me madhësi të xhept, kalkulatorë që flasin me zë, laptopë, etj., ndërsa studentët që lëvizin me ndihmën e një karroce me rrota mund të paraqesin një kërkesë për përdorimin e shërbimeve të transportit falas të furgonëve, transport që kryhet përmes qytetit të Zagrebit.

Konviktet e studentëve janë përshtatur për studentët me aftësi të kufizuara, dhe komuna gjithashtu ofron mbështetje 24-orëshe në një pjesë të konvikteve për ata studentë që kanë forma më të rënda të aftësisë së kufizuar fizike.

Përveç kësaj, Universiteti i Zagrebit ka krijuar një zyrë për studentët me aftësi të kufizuara që funksionon si një organ qendror koordinues për ofrimin e mbështetjes zyrtare për studentët, ndërsa për nevojat individuale të studentëve, koordinatorët për mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara mund të jenë

gjithashtu mbështetje. Në disa nga qytetet ku ndodhen fakultetet më të mëdha, ka edhe shoqata për studentët me aftësi të kufizuara që ofrojnë forma specifike të mbështetjes formale në përputhje me nevojat individuale të studentëve.

Universiteti publikon rregullisht informacione për studentët me aftësi të kufizuara në faqen e tij të internetit, dhe gjithashtu ndan informacionin përmes ligjëratave hyrëse në fakultetet ku shërbimi për ofrimin e mbështetjes formale u paraqitet edhe studentëve të vitit të parë. Studentët me aftësi të kufizuara, por edhe ata që kanë vështirësi në mësim, kanë mundësi të ndjekin individualisht klasat dhe të japin provimet, sipas nevojave të tyre, dhe kështu universiteti përshtatet në përputhje me rrethanat.

Përveç praktikës pozitive të theksuar në këtë analizë dhe mund të merret si shembull nga universitetet dhe fakultetet vendase, infrastruktura e papërshtatshme dhe jopërkatese e disa fakulteteve, mjetet e pamjaftueshme të përshtatura për transport, stafi i pandjeshëm i disa fakulteteve dhe disa sfida të tjera ende qëndrojnë përpara në Kroaci në mënyrë që të sigurojë një sistem arsimor më gjithëpërfshirës dhe më të përballeshëm për studentët me aftësi të kufizuara.³¹

31 Shih më shumë në: <https://hrcak.srce.hr/file/361773> dhe <https://www.unizg.hr/studiji-i-studiranje/podrka-studentima/ured-za-studente-s-invaliditetom/oblici-potpore/>

TË DHËNA NGA ANALIZA E PYETËSORËVE ME FAKULTETE

Pyetësori i destinuar për fakultetet u dërgua në gjithsej 67 fakultete, nga të cilat 40 u mbuluan në analizë. Numri i përgjithshëm i katedrave/instituteve/njësive në të 40 fakultetet është 240. Pyetësori ishte dërguar me qëllim të mbledhjes të informacioneve për qasshmërinë fizike të objekteve të fakulteteve që janë në kuadër të universiteteve shtetërore, literaturën në dispozicion në një format të qasshëm, disponueshmërinë e teknologjisë asistive dhe/ose llojit tjetër të mbështetjes së individualizuar për studentët me aftësi të kufizuara, si dhe vlerësimin e numrit të studentët me aftësi të kufizuara në të tre ciklet e studimeve.

Shumica e fakulteteve që iu përgjigjën pyetësorit ekzistojnë mesatarisht pas 35 vjetësh. Numri i përgjithshëm i personave aktualisht të punësuar me aftësi të kufizuara në fakultetet në pjesën administrative dhe në stafin mësimor (asistentë, docentë, profesorë, etj.) është 4.

Të dhënat statistikore për studentët me aftësi të kufizuara


Në fakultetet e mbuluara nga analiza u regjistruan gjithsej 21.048 studentë në ciklin e parë të studimeve, 2.443 studentë në ciklin e dytë dhe 1.132 studentë në ciklin e tretë të studimeve. Vetëm 45 studentë ose 0.21% e studentëve në ciklin e parë të studimeve janë me aftësi të kufizuara, 2 në ciklin e dytë dhe vetëm 1 student në ciklin e tretë të studimeve.

Tabela numër 1

	I parë	I dytë	I tretë
Numri i përgjithshëm i studentëve	21.048	2.443	1.121
Studentët me aftësi të kufizuara	45 (0,21%)	2 (0,08%)	1 (0,09%)

Sipas përgjigjeve të fakulteteve, studentët e përfshirë në arsimin e lartë kanë llojë të ndryshme të aftësive të kufizuara, nga të cilat kryesisht janë studentë me aftësi të kufizuara trupore (15%) dhe lloje të tjera të aftësive të kufizuara (15%). Sipas përgjigjeve, nuk ka studentë me aftësi të kufizuara intelektuale në universitete.

Çfarë lloji të aftësisë së kufizuar/vështirësisë në nxënie kanë këta studentë?



Kampusi që spikati si shembull pozitiv në këtë drejtim ka siguruar tualetet përmes një projekti. Fatkeqësisht, edhe në këtë rast, në 3 nga 4 fakultete në kampus tualetet e qasshme ishin të mbyllura. Kjo do të thotë se nga 26 fakultetet e vizituara për nevojat e kësaj këqyrje, vetëm 1 fakultet në kuadër të 1 kampusi, tualetet ishin të qasshme dhe të hapura për përdorim nga studentët dhe të punësuarit me aftësi të kufizuara.

Në pjesën e jashtme të njërit prej kampuseve, ka pasur devijim në drejtim të gjerësisë dhe pjerrësisë së **rampave**. Këto rampa kanë mbajtëse më të larta se standardet e përshkruara në rregullore dhe standardet ndërkombëtare. Në pjesën e brendshme të fakulteteve, rampat kanë devijime serioze në këndin e pjerrët, duke filluar nga 16 deri në 23 shkallë, kundrejt maksimumit të lejuar 8 shkallë. Te mbajtësit dhe gjërësia e këtyre rampave, ka edhe devijime serioze nga rregulloret.

Këto mangësi nuk mund t'i atribuohen hapësirës së pamjaftueshme rreth rampave, sepse e njëjta ekziston. Gardhet (aty ku janë të pranishme), më së shpeshti u ngjajnë gardheve të vendosura në shkallë, gjë që tregon se ato janë zgjedhur për t'iu përshtatur enterierit, në vend të nevojave të përdoruesve.

Shkallët e fakulteteve janë në kuadër të standardeve. Shmangja më e zakonshme për ta është mungesa e një mbajtësi/ kapëse dore të përshtatshme. Përveç kësaj, nuk ka asnjë shenjë paralajmëruese tekstile në asnjë shkallë në fillim dhe në fund, madje as në një kampus që ka shtigje taktile kudo.

Ashensorë



Megjithëse ka nevojë për **ashensorë**, dy nga kampuset e vizituara nuk i kanë ato. Ato kampuse që kanë ashensorë janë ashensorë me dimensione të kënaqshme, me pasqyrë, mbajtëse, por me mungesë të shenjave të shkrimit brail. Megjithëse janë të sakta, jo të gjitha ashensorët janë në përdorim për shkak të keqpërdorimit nga studentët pa aftësi të kufizuara ose për shkak të ligjeratave të përfunduara gjatë periudhës së verës. Disa

nga fakultetet, veçanërisht aty ku ka deri në 6-7 shkallë për t'u ngjitur, kanë platforma për të tejkaluar lartësinë. Megjithatë, këto platforma nuk janë në përdorim aktiv dhe as nuk janë të thjeshta për t'u përdorur.

Nuk ka parkim të shënuar



Parkimi për personat me aftësi të kufizuara nuk shënohet në 2 nga 4 kampuset e fakulteteve. Aty ku është e mundur, dimensionet e përcaktuara për qasshmërinë, sipas rregullave që rregullojnë qasshmërinë e hapësirave të parkimit në nivel kombëtar, u përmbushën. Për fat të keq, në një nga kampuset vetë vendet e shënuara të parkimit u shndërruan në një hyrje në parking.

Parkim i shënuar



Në lidhje me **shkrimet dhe njoftimet** e fakulteteve, ekziston një kontrast i vogël midis tekstit dhe sfondit, i cili është një kufizim serioz për studentët me shikim të dëmtuar. Ka një numër të madh të shkrimeve me font shumë të vogël, të pozicionuara në mënyrë jopërkatëse, të cilat në kohë të caktuara edhe një person me karrocë nuk mund t'i lexonte, sepse nuk mund t'i afrohej sa duhet.

Ka hapësira më të rrezikshme dhe të pasigurta nëpër fakultete që mund të kërcënojnë seriozisht shëndetin e studentëve me aftësi të kufizuara. Siç ndanë personat përgjegjës në fakultete, më shpesh **planet e evakuimit** nuk janë mjaftueshëm të qasshme për të gjithë studentët me aftësi të kufizuara, dhe ka fakultete që nuk kanë fare plane të tilla.

Nga kampuset që u vizituan, nuk kishte **shenja paralajmëruese taktile** në fillim dhe në fund të shkallëve, gjë që përbën një kërcënim për studentët me shikim të dëmtuar, veçanërisht ata që janë më pak të aftë të përdorin një shkop të bardhë dhe të lëvizin në një hapësirë të re. Në të 4 kampuset ka **elemente të varura** në përplasje me të cilat mund të lëndohen studentët me shikim të dëmtuar.

Asnjë **zyrë për mbështetjen e drejtpërdrejtë të studentëve me aftësi të kufizuara** nuk u gjet në asnjë nga kampuset e vizituara dhe vetëm një nga kampuset filloi një procedurë për inçizimin e **teksteve shkollore audio**.

PËRFUNDIME

Megjithëse vendi ynë ka ndërmarrë disa hapa për të futur gjithëpërfshirjen në arsim, Ligji për Arsimin e Lartë si dhe Strategjia nacionale për arsim 2018-2025 nuk bazohen në një qasje të tërërishtme dhe gjithëpërfshirëse dhe nuk janë në përputhje me Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Në përgjithësi, statutet e universiteteve, përveçse rregullojnë përgjithësisht ndalimin e diskriminimit dhe mundësinë e afateve shtesë për kalimin e një kategorie të caktuar studentësh, ato nuk shkojnë më tej në avancimin e të drejtave dhe plotësimin e nevojave individuale të studentëve me aftësi të kufizuara.

Fakultetet në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk mbajnë evidencë statistikore për numrin e studentëve me aftësi të kufizuara, të ndarë sipas parametrave të rëndësishëm, përmes të cilëve do të avancoheshin politikat, qasshmëria dhe shërbimet për studentët.

Transporti publik në qytetet me fakultete është plotësisht i paqasshëm për disa studentë me aftësi të kufizuara, veçanërisht për ata që janë përdorues të karrocave dhe/ose janë me dëmtim të plotë të shikimit, dhe është pjesërisht i qasshëm për studentët e tjerë me aftësi të kufizuara. Ndër të tjera, shumë fakultete nuk kanë hapësira parkimi që janë adekuate dhe të shënuara për personat me aftësi të kufizuara.

Përveç faktit që shumë nga fakultetet kanë qasshmëri fizike të kënaqshme në oborre dhe në korridoret në brendësi, pjesët e mbetura janë kryesisht me qasshmëri fizike të pakënaqshme. Më shumë mungojnë tualetet funksionale të qasshme, ashensorët funksionalë të qasshëm dhe rampat e qasshme me gjerësi dhe kënd të përshtatshëm të pjerrët, qasja e papenguar deri në dhe

në sallat e ligjeratave, amfiteatrot, korridoret, sportelet e larta të përshtatshme të shërbimeve për pyetjet e studentëve, shtigjet taktile të vendosura në mënyrë përkatëse, etj.

Siguria e studentëve me aftësi të kufizuara në rast të fatkeqësive natyrore ose rreziqeve të tjera është shumë e ulët, pasi shumë prej fakulteteve nuk kanë një plan për evakuim në një format të qashtëm, as një alarm funksional audio-vizual. Nga ana tjetër, informimi i studentëve në të gjitha fakultetet kryhet në mënyrë të paqashtëm. Asnjë fakultet nuk publikon njoftimet, politikat dhe dokumentet e tyre kryesore në formatin e shkrimit brail, formatin audio të qashtëm ose shkrimin standard në formatin e rritur.

Shërbimet digjitale të fakulteteve, të tilla si indeksi elektronik dhe faqet e internetit të universiteteve dhe fakulteteve, në pjesën më të madhe nuk janë testuar për të përcaktuar nëse ato janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të qashtëmërisë. Shërbimet administrative të fakulteteve për pjesën më të madhe të studentëve me aftësi të kufizuara janë të paqashtëmë, fakultetet nuk kanë persona të caktuar zyrtarisht në shërbimet e pyetjeve studentore të cilët do të ishin në mbështetje të studentëve me aftësi të kufizuara në regjistrim, vërtetim, paraqitje për provime, etj.

Për një numër të madh të programeve mësimore dhe një numër të madh fakultetesh, ka mungesë të literaturës profesionale dhe shkencore në një format të qashtëm (shkrimi brail, formati audio, format të zgjeruar të shtypur dhe format digjital të qashtëm) për të cilin kanë nevojë studentët me aftësi të kufizuara gjatë studimit. As shteti dhe as fakultetet nuk ofrojnë në mënyrë sistimore teknologji ndihmëse për studentët me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për studimet e tyre, dhe disa nga fakultetet nuk janë të njohur me kuptimin e kësaj teknologjie.

Pjesa më e madhe e fakulteteve nuk ofrojnë shërbime specifike për studentët me aftësi të kufizuara, siç janë asistenti i marrjes së shënimeve, interpretuesi i gjuhës së shenjave, trajnimi i orientimit dhe lëvizshmërisë, sigurimi i provimeve në një format të qasshëm, sigurimi i kohës shtesë të provimeve, etj.

Shteti ynë ka ende sfida të shumta për të ofruar arsimin e lartë gjithëpërfshirës, i cili kërkon një vlerësim dhe njohje të nevojave individuale të studentëve me aftësi të kufizuara në vend, rritjen e vetëdijes dhe sensibilizimit nga universitetet, fakultetet dhe institucionet e tjera shtetërore për të drejtat dhe nevojat e kësaj kategorie të personave, duke ndjekur shembujt krahasues pozitivë dhe të suksesshëm nga rajoni dhe një përpjekje të vazhdueshme që kërkon angazhim dhe bashkëpunim kolektiv.

REKOMANDIME

Megjithëse universitetet dhe fakultetet në pjesën më të madhe kanë detyrimin të përshtaten dhe miratojnë në mënyrë të përshtatshme masa dhe politika mbështetëse për të përmbushur nevojat individuale të studentëve me aftësi të kufizuara, nuk janë vetë ata përgjegjës për sigurimin e qasjes adekuate në arsimin e lartë për këtë kategori të personave.

Ministria e arsimit dhe shkencës duhet të nisë iniciativa që do të kërkojnë mbajtjen e evidencës digjitale të detyrueshme për studentët me aftësi të kufizuara, dhe së bashku me Qeverinë të përfshijë qasshmërinë si kriter në planifikimin e fakulteteve dhe konvikteve. Ministria e transportit dhe lidhjeve dhe inspektoratet kompetente duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë asaj se sa fizikisht të qasshme janë fakultetet për studentët me aftësi të kufizuara dhe të përmbushin standardet dhe normat për ndërtim, si dhe të sigurojnë që studentët me aftësi të kufizuara të kenë qasje në dhe nga fakultetet.

Disa nga rekomandimet për të cilat këto institucione kompetente duhet të veprojnë janë si më poshtë:

1. Mbajtja e detyrueshme e evidencës digjitale për statistikën për studentët me aftësi të kufizuara, me qëllim planifikimin më të mirë sipas nevojave të tyre dhe sigurimin e gjithëpërfshirjes së fakulteteve.
2. Zbatimi i detyrueshëm i parimit të përshtatjes së duhur nga ana e fakulteteve, me qëllim të plotësimit të nevojave të studentëve me të gjitha llojet e aftësive të kufizuara, si ndryshimi i hapësirës për dhënien e provimeve, sigurimi i një periudhe shtesë kohore për dhënien e provimit, ofrimi i testeve në një format të qasshëm, etj.
3. Përfshirja e detyrueshme e qasshmërisë si kriter në furnizimin, rindërtimin dhe planifikimin strategjik të fakulteteve dhe konvikteve studentore.
4. Sigurimi i transportit të qasshëm për studentët me aftësi të kufizuara dhe shënimi i hapësirave të parkimit për personat me aftësi të kufizuara në fakultete.
5. Sigurimi i infrastrukturës fizike të fakulteteve, respektivisht vendosja e shtigjeve hyrëse, rampave, ashensorëve, tualeteve, në përputhje me standardet e nevojshme.
6. Testimi i rregullt i qasshmërisë së faqeve të internetit dhe shërbimeve elektronike të fakulteteve dhe sigurimi i burimeve digjitale të dizajnuara dhe të mirëmbajtura për të përmbushur nevojat e personave me çdo lloj aftësie të kufizuar.
7. Sigurimi i literaturës profesionale dhe shkencore në formate të qasshme.
8. Sigurimi i teknologjisë asistive dhe pajisjeve ndihmëse dhe krijimi i politikave të fakultetit për përdorimin e tyre.

9. Caktimi formal i asistentëve administrativë për mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara.
10. Sigurimi i interpretuesve të gjuhës së shenjave, veçanërisht gjatë ligjëratave dhe dhënies së provimeve.
11. Përforcimi i bashkëpunimit midis organizatave të shoqërisë civile dhe studentëve me aftësi të kufizuara me qëllim ndërtimin e partneritetit dhe mbështetjes në procesin e studimit.
12. Rritja e vetëdijes të kuadrit mësimor, strukturave udhëheqëse, administratës së fakultetit për nevojat e sigurimit të qasshmërisë për studentët me aftësi të kufizuara, si dhe për mënyrat në të cilat secili prej tyre mund ta ofrojë atë.
13. Promovimi i programeve të studimit për të rinjtë me aftësi të kufizuara në mënyrë që të inkurajohet përfshirja e tyre në arsimin e lartë.

SHTOJCA 1:

PYETËSOR PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE NGA FAKULTETET

Sqarim para plotësimit të pyetësorit

Pyetjet në këtë pyetësor janë të thjeshta, në të shumtën e rasteve përgjigjen përmes përzgjedhjes së një prej disa përgjigjeve të ofruara, rrethimin e një ose më shumë pohimeve, respektivisht me mundësi për shënimin e numrave dhe tekstit në disa fusha. Rekomandimi ynë është, së pari t'i shtypim pyetjet e njëjta që gjenden në versionin PDF të këtij pyetësori që ju është dërguar përmes postës elektronike, që t'i mblidhni të dhënat dhe më pas të filloni me plotësimin e tij onlajn. Keni parasysh se në disa pyetje përmenden dimensione të sakta me qëllim që pyetja të jetë më e qartë për plotësuesin. Për këto pyetje mjafton të shërbeheni me ndjenjën tuaj për vlerësim të lirë të hapësirës, pa përdorur me këtë rast vegla për matje.

Koha e nevojshme për plotësimin e këtij pyetësori, nëse tashmë i keni mbledhur të dhënat, do të duhej t'ju marrë jo më shumë se 1 orë.

Afati për plotësimin e këtij pyetësori është 15 qershor, viti 2023 deri në 23:59.

Ju faleminderit paraprakisht për përkushtimin dhe sinqeritetin gjatë dhënies së përgjigjeve.

A) Informacione për institucionin e lartë arsimor:

1. Emërtimi i plotë i fakultetit:

2. Numri momental i katedrave/instituteve:

(Lejohet shënimi vetëm i numrave)

3. Vitet e funksionimit si institucion publik i arsimit të lartë:

(Lejohet shënimi vetëm i numrave)

4.1. Numri momental i studentëve të regjistruar në ciklin e parë të studimeve të fakultetit:

(Lejohet shënimi vetëm i numrave)

4.2. Numri momental i studentëve të regjistruar në ciklin e dytë të studimeve të fakultetit:

(Lejohet shënimi vetëm i numrave)

- 4.3. Numri momental i studentëve të regjistruar në ciklin e parë të studimeve të fakultetit:

(Lejohet shënimi vetëm i numrave)

5. Numri i përgjithshëm i personave me aftësi të kufizuara që janë të punësuar për momentin në fakultetin në pjesën administrative dhe në kuadrin mësimdhënës (asistentë, docentë, profesorë...):

(Lejohet shënimi vetëm i numrave)

B) Mbledhja e të dhënave për numrin e studentëve me aftësi të kufizuara

- 6.1.1. Për momentin, sa studentë të rregullt me aftësi të kufizuara keni në ciklin e parë të studimeve në fakultetin tuaj?

(Lejohet shënimi vetëm i numrave)

- 6.1.2. Për momentin, sa studentë të çrregullt me aftësi të kufizuara keni në ciklin e parë të studimeve në fakultetin tuaj?

(Lejohet shënimi vetëm i numrave)

6.2.1. Për momentin, sa studentë të rregullt me aftësi të kufizuara keni në ciklin e dytë të studimeve në fakultetin tuaj?

(Lejohet shënimi vetëm i numrave)

6.2.2. Për momentin, sa studentë të çrregullt me aftësi të kufizuar keni në ciklin e dytë të studimeve në fakultetin tuaj?

(Lejohet shënimi vetëm i numrave)

6.3.1. Për momentin, sa studentë të rregullt me aftësi të kufizuara keni në ciklin e tretë të studimeve në fakultetin tuaj?

(Lejohet shënimi vetëm i numrave)

6.3.2. Për momentin, sa studentë të çrregullt me aftësi të kufizuar keni në ciklin e tretë të studimeve në fakultetin tuaj?

(Lejohet shënimi vetëm i numrave)

7. Çfarë lloji të aftësisë së kufizuar/vështirësisë në nxënie kanë këta studentë? (rrethoni të gjitha aftësitë e kufizuara me të cilat përballen studentët tuaj të tanishëm)
- Shikim të dëmtuar (të verbër dhe me shikim të dobët)
 - Dëgjim të dëmtuar (të shurdhër dhe me dëgjim të dobët)
 - Vështirësi në nxënie (disleksi, diskalkuli, disgrafi ose dispraksi)
 - Autizëm (çrregullim nga spektri i autizmit)
 - Aftësi të kufizuar trupore (persona në karrocë ortopedike, persona përdorues të mjeteve të tjera ndihmëse ortopedike për lëvizje, etj.)
 - Aftësi e kufizuar intelektuale
 - Sindroma e Daunit
 - Paralizë cerebrale
 - Kombinim i më shumë se një aftësie të kufizuar
 - Lloj tjetër të aftësisë së kufizuar që nuk është përmendur në përgjigjet e ofruara më sipër
 - Nuk mbahet evidencë për llojin e aftësisë së kufizuar të studentëve

- 8.1. Në 2 vitet e fundit (nga fillimi i vitit 2021 deri në ditën e plotësimit) sa studentë me aftësi të kufizuar kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve në fakultetin tuaj?

(Lejohet shënimi vetëm i numrave)

- 8.2. Në 2 vitet e fundit (nga fillimi i vitit 2021 deri në ditën e plotësimit) sa studentë me aftësi të kufizuar kanë mbaruar ciklin e dytë të studimeve në fakultetin tuaj?

(Lejohet shënimi vetëm i numrave)

- 8.3. Në 2 vitet e fundit (nga fillimi i vitit 2021 deri në ditën e plotësimit) sa studentë me aftësi të kufizuar kanë mbaruar ciklin e tretë të studimeve në fakultetin tuaj?

(Lejohet shënimi vetëm i numrave)

9. Çfarë lloji të aftësisë së kufizuar/vështirësive në nxënie kanë pasur këta studentë? (rrethoni të gjitha aftësitë e kufizuara me të cilat përballeshin studentët tuaj që kanë mbaruar fakultetin tuaj në 2 vitet e fundit në periudhën janar 2021 deri në ditën e plotësimit të këtij pyetësori)
- Shikim të dëmtuar (të verbër dhe me shikim të dobët)
 - Dëgjim të dëmtuar (të shurdhër dhe me dëgjim të dobët)
 - Vështirësi në nxënie (disleksi, diskalkuli, disgrafi ose dispraksi)
 - Autizëm (çrregullim nga spektri i autizmit)
 - Aftësi të kufizuar trupore (persona në karrocë ortopedike, persona përdorues të mjeteve të tjera ndihmëse ortopedike për lëvizje, etj.)
 - Aftësi e kufizuar intelektuale
 - Sindroma e Daunit
 - Paralizë cerebrale
 - Kombinim i më shumë se një aftësie të kufizuar
 - Lloj tjetër të aftësisë së kufizuar që nuk është përmendur në përgjigjet e ofruara më sipër
 - Nuk mbahet evidencë për llojin e aftësisë së kufizuar të studentëve

C) Informacione për qasjen momentale në fakultetin

10. A ka në parkingun e fakultetit tuaj vende të shënuara për parkim për persona me aftësi të kufizuar?
- Po, ka
 - Po, por vetëm në parkingjet për një pjesë të objekteve
 - Jo, nuk ka parking të posaçëm të shënuar për persona me aftësi të kufizuar në parkingun e fakultetit
 - Jo, meqë fakulteti nuk ka parkingun e vet
- 10.1. A ka qasje të papenguar për personat me karrocë ortopedike nga vendet e shënuara të parkimit për persona me aftësi të kufizuar deri te hyrja kryesore e fakultetit, kjo nënkupton të ketë trotuare me bordure të pjerrëta dhe vende të parrafshëta, që nuk janë më të mëdha se 2 centimetra?
- Po, ka në të gjitha objektet në të cilat funksionon fakulteti
 - Po, por jo në të gjitha objektet në të cilat funksionon fakulteti
 - Jo, nuk ka fare

11. A ka në afërsi të hyrjes kryesore të ndërtesës së fakultetit hapësirë të gjerë (minimum 9 x 3.6 metra) ku mund të ndalet automjet taksi ose furgon për të lënë në mënyrë të sigurt një udhëtar, person me aftësi të kufizuar?
- Po, ka edhe atë në largësi prej së paku 50 m nga hyrja kryesore
 - Po, ka, por është më larg se 50 m nga hyrja kryesore
 - Jo, nuk ka hapësirë aq të madhe ku mund të ndalet në rrethinën e fakultetit
- 11.1. A ka shteg të vendosur taktil nga hapësira ku mund të ndalet automjeti taksi ose furgon, respektivisht nga rruga deri te hyrja kryesore e fakultetit?
- Po, ka shteg të vendosur taktil nga rruga në hyrjen kryesore nga të gjitha objektet në të cilat funksionon fakulteti
 - Po, ka shteg taktil, por ajo nuk shpie drejt të gjitha objekteve në të cilat funksionon fakulteti
 - Jo, nuk ka shteg të vendosur taktil në pjesën e jashtme të fakultetit

- 11.2. Nga hapësira ku mund të ndalet automjeti taksi ose furgon, respektivisht nga rruga deri te hyrja e fakultetit ka trotuare me bordure të pjerrëta pa plasaritje të mëdha me çka persona në karrocë ortopedike do të mund të mbërrijnë deri te hyrja e ndërtesës së fakultetit?
- Po, hapësira ndërmjet rrugës dhe hyrjes kryesore të ndërtesës së fakultetit është me bordura të pjerrëta të trotuareve dhe pa gunga të mëdha
 - Po, por deri te disa ndërtesa/objekte në të cilat funksionon fakulteti megjithatë ka bordure të larta dhe gunga më të mëdha
 - Jo, hapësira ndërmjet vendit të shënuar për ndalje, respektivisht rruga dhe hyrja kryesore e ndërtesës së fakultetit në tërësi është jo e rrafshët dhe e paarritshme në aspektin fizik
12. A ka në hyrjen e ndërtesës së fakultetit tuaj rampa përkatëse funksionale për qasje me karrocë ortopedike për persona me aftësi të kufizuar trupore?
- Po, ka rampa përkatëse në të gjitha hyrjet e të gjitha objekteve
 - Por, por jo në të gjitha objektet dhe hyrjet
 - Jo, nuk ka rampa përkatëse në asnjërën prej hyrjeve

13. Vallë dyert kryesore hyrëse të fakultetit tuaj:
- Hapen në mënyrë automatike me rrëshqitje anësore
 - Hapen në mënyrë automatike me rrotullim/ rrotullim në rreth
 - Hapen me dorë nga ana e brendshme
 - Hapen me dorë nga ana e jashtme
- 13.1. Krahas derës rrotulluese, e cila në parim është e paarritshme sipas natyrës së saj, në hyrjen kryesore të fakultetit a ka derë tjetër të arritshme që hapet me dorë ose me rrëshqitje anësore?
- Po
 - Jo
14. A ka brendia e fakultetit ku lëvizin studentët korridore më të ngushta se 1.2 metra?
- Jo, nuk ka,
 - Po, por vetëm në disa vende
 - Po, nëpër të gjitha objektet e fakultetit

15. A kanë shkallët në fakultetin rrethojë në formë të mbajtësit për të cilin do të mund të mbahej një person derisa ngjitet dhe zbret nëpër to?
- Po, të gjitha shkallët kanë rrethojë në formë të mbajtësit nga të dyja anët
 - Po, të gjitha shkallët kanë rrethojë në formë të mbajtësit, por vetëm nga njëra anë e tyre
 - Jo, shkallët kanë rrethojë, por ajo nuk është në formë të mbajtësit për të cilin do të mund të mbahej një person që ngjitet dhe zbret nëpër to
16. A ka shenja të vendosura taktile para fillimit të shkallëve dhe në fund të shkallëve?
- Po, në të gjitha shkallët ka shenja të vendosura taktile
 - Në disa shkallë ka, në disa shkallë nuk ka shenja të vendosura taktile
 - Jo, në asnjë shkallë nuk ka shenja të vendosura taktile

17. A ka shenja të vendosura vizuale në fillim dhe në fund të shkallëve?
- Po, në të gjitha shkallët ka shenja të vendosura vizuale
 - Në disa shkallë ka, në disa shkallë nuk ka shenja të vendosura vizuale
 - Jo, në asnjë shkallë nuk ka shenja të vendosura vizuale
18. A ka nëpër fakultet elemente të vendosura varëse si aparate zjarrfikëse, banerë dhe shenja të tjera, sende dhe objekte që janë në zonën e lëvizjes dhe janë më të ulëta se 2.1 metra?
- Po, ka, por vetëm në disa objekte dhe ato nuk janë të mbrojtura e as të shënuara në mënyrë përkatëse
 - Po, ka, në të gjitha objektet dhe ato nuk janë të mbrojtura e as të shënuara
 - Po, ka, por vetëm në disa objekte dhe ato janë të mbrojtura dhe të shënuara
 - Po, ka, në të gjitha objektet dhe ato janë të mbrojtura dhe të shënuara
 - Jo, nuk ka barriera të tilla

19. A ka në brendinë e fakultetit, veçanërisht në pjesën ku lëvizin studentët, pragje në dyert/dallime në lartësi (shkallë) më të larta se 2 centimetra për të cilat nuk është siguruar qasje fizike me rampë të pjerrët, ashensor, etj.?
- Po, ka dallime të tilla në lartësi dhe pragje nëpër të gjitha objektet në të cilat funksionon fakulteti
 - Po, ka dallime të tilla në lartësi dhe pragje, por vetëm në disa objekte/hapësira në të cilat funksionon fakulteti
 - Jo, nuk ka dallime të tilla në lartësi dhe pragje në asnjë vend në fakultet
20. A është dyshemeja e fakultetit prej pllakave ose materialeve të tjera në më shumë se një ngjyrë ndërmjet të cilave në aspektin vizual dallohet kontrast më i madh?
- Po, në të gjitha objektet dyshemeja është në ngjyra kontraste
 - Jo, vetëm në disa vende dhe në disa objekte dyshemeja është në ngjyra kontraste
 - Jo, dyshemeja është njëngjyreshe, respektivisht me dallim të vogël ndërmjet ngjyrave në të nëpër gjithë fakultetin

21. A ka në fakultetin ashensor me minimum dimensione 1.1 x 1.4 metro?
- Po, ka ashensor me këto dimensione
 - Po, ka ashensor por është më i vogël se dimensionet e përmendura në pyetjen
 - Po, ka ashensor me ato dimensione, por nuk shkon deri te të gjitha katet
 - Po, ka ashensor por jo në të gjitha objektet në të cilat funksionon fakulteti
 - Jo, nuk ka ashensor meqë fakulteti është vetëm në një kat dhe nuk ka nevojë për të
 - Jo, nuk ka ashensor ndonëse ka nevojë për të meqë fakulteti është në disa kate
- 21.1. A ka në ashensorin shenja taktile me alfabetin e Brajtit në të?
- Po, ka edhe në kopsën për thirrjen e ashensorit nga ana e jashtme dhe të kopsave në brendinë
 - Po, por vetëm kopsat në brendinë
 - Po, por vetëm në kopsën e jashtme për thirrje
 - Jo, nuk ka shenja të tilla taktile

21.2. A ka në brendinë e ashensorit dorezë të vendosur horizontalisht për t' u mbajtur?

- Po, ka
- Jo, nuk ka

21.3. A ka pasqyrë të vendosur në ashensorin në anën përballë derës për hyrje dhe dalje prej tij?

- Po, ka
- Jo, nuk ka

21.4. Sa shpesh ashensori është jashtë përdorimit?

- Thua jse gjithmonë është në përdorim (mbi 95 % të kohës)
- Është në përdorim (mbi 60 % të kohës)
- Shumë pak është në përdorim (vetëm deri 20 % të kohës)
- Thua jse asnjëherë nuk është në përdorim (vetëm deri 5 % të kohës)

21.5. Si hapet dera e ashensorit?

- Në mënyrë automatike /të mëvetësishme
- Në mënyrë manuale /me dorë

22. A ka nëpër fakultet dyer të tejdukshme prej xhami ose mure prej xhami që nuk janë të shënuara me shirita të ngjyrosur kontrast në midis?
- Jo, meqë fakulteti nuk ka dyer prej xhami ose mure prej xhami
 - Po, ka dyer/mure prej xhami që nuk janë të shënuar, por edhe dyer/mure që janë të shënuara
 - Po, të gjitha dyert dhe muret prej xhami që i ka fakulteti nuk janë të shënuara në mënyrë të këtillë
23. A janë nëpër fakultet dyert e hapësirave kyçe (kabinete, ligjërata, tualete, biblioteka, etj.) në ngjyrë tjetër, kontraste kundrejt ngjyrës së mureve rreth tyre?
- Po, ka dallim të dukshëm mes ngjyrës në të gjitha dyert nëpër fakultet dhe ngjyrës në muret rreth tyre
 - Po, por në disa vende ka edhe dyer që janë me ngjyrë të njëjtë ose shumë të ngjashme me ngjyrën e mureve rreth tyre
 - Jo, në parim të gjitha dyert janë me ngjyrë të njëjtë ose shumë të ngjashme me ngjyrën e mureve rreth tyre

24. Në çfarë forme janë dorezat e dyerve të hapësirave kyçe nëpër fakultetin? (shënoni të gjitha format e dorëzave që i ka fakulteti juaj)
- Në formën e një levë të vetme horizontale që shtypet poshtë (doreza standarde)
 - Në formë të topit/birilës që kapet me shputën e dorës dhe rrotullohet
 - Në formë të tubit të gjatë të papënguar horizontal që për nga gjerësia e gjithë derës dhe në mënyrë që të hapet dera mund të shtypet kudo në të
 - Në formë të dorezës vertikale që kapet me shputën e dorës dhe të tërhiqet ose shtyhet
25. Në çfarë mënyre janë shënuar hapësirat kyçe nëpër fakultetin si hapësira për çështje studentore, kabinetet, amfiteatrot, hapësirat për ligjërata, tualetet, zyra e dekanit, etj.?
- Janë shënuar në mënyrë vizuale me tabela në të cilat ka ekskluzivisht vetëm tekst
 - Janë shënuar në mënyrë vizuale me tabelë në të cilën krahas tekstit ka edhe simbol grafik të pranuar përgjithësisht
 - Janë shënuar me tabelë vizuale dhe me tabelë me alfabetin e Brajlit deri te e cila ka shteg taktik
 - Janë shënuar në mënyrë të ndryshme për shkak të mungesës së mënyrës së harmonizuar të shënimit
 - Nuk janë të shënuara në asnjë mënyrë

26. Në mbishkrimet dhe tabelat në fakultet a përdoren ngjyra e kuqe, e gjelbër, e kaltër dhe e verdhë?
- Jo, mbishkrimet shkruhen me ngjyra të tjera nga ato që përmenden në pyetjen
 - Po, por jo në të gjitha tabelat
 - Po, në të gjitha tabelat
27. A janë sportelet në shërbimin për çështje studentore më të larta se 80 centimetra?
- Jo, të gjitha sportelet janë me lartësi deri 80 cm dhe me mundësi për përdorimin e tyre nga ndonjë person në karrocë ortopedike
 - Po, por ka një pjesë që janë të larta deri 80 cm dhe me mundësi për përdorim nga persona me karrocë ortopedike, por edhe një pjesë që janë më të larta
 - Po, të gjitha sportelet janë më të larta se 80 centimetra dhe pa mundësi për përdorimin e tyre nga ndonjë person me karrocë ortopedike

28. A keni vendosur së paku në njërin nga sportelet e shërbimit për çështje studentore sistem që forcon zërin e administratorit që i flet studentit?
- Po, kemi dhe është në funksion
 - Po, kemi por nuk është në funksion
 - Jo, nuk kemi vendosur
29. A ka në të gjitha objektet në të cilët lëvizin studentë nga së paku 1 tualet të arritshëm për persona që përdorin karroce ortopedike? (I arritshëm konsiderohet ai tualet ku ka më së paku 120 centimetra para dhe së paku 60 centimetra nga njëra anë e vc-guaskës, me mbajtës pranë vc-guaskës, me derë që hapet nga jashtë dhe me lavaman të varur nën të cilin mund të hyjë një pjesë e karrocës ortopedike.)
- Po, në të gjitha ndërtesat e fakultetit ka së paku nga 1 tualet të arritshëm
 - Po, por jo në të gjitha ndërtesat/objektet në të cilat funksionon fakulteti
 - Jo, nuk ka tualete të arritshme në fakultetin
30. A ka në fakultetin alarm të vendosur për raste emergjente?
- Po, ka alarm të vendosur në të gjitha objektet
 - Po, por nuk është vendosur në të gjitha objektet
 - Jo, nuk kemi vendosur alarm

- 30.1. A është alarmi që është vendosur funksional?
- Po, është funksional në të gjitha objektet,
 - Po, por vetëm në disa objekte
 - Jo, nuk është funksional
- 27.2. A është alarmi i vendosur:
- Vetëm zanor
 - Vetëm vizual
 - Edhe zanor edhe vizual
31. Në çfarë forme e keni planin për evakuim në rast zjarri, përmbajtjes ose fatkeqësive të tjera natyrore në objektet tuaja? (rrethoni të gjitha pohimet e ofruara që i përshtaten fakultetit tuaj)
- Nuk kemi plan të theksuar për evakuim
 - Kemi plan për evakuim vetëm në formë vizuale,
 - Kemi plan për evakuim në formatin lehtësisht të lexueshëm
 - Kemi plan për evakuim në formatin taktil me alfabetin e Brajlit
 - Kemi plan për evakuim në formatin zanor.
 - Kemi plan për evakuim në formatin digjital

32. A janë ueb-faqja e fakultetit dhe përmbajtjet që i vendosni në të, të arritshme për studentët me aftësi të kufizuar?
- Po, është e arritshme, e testojmë rregullisht gjatë çdo përditësimi më të madh
 - Po, konsiderojmë se është e arritshme, por nuk e kemi testuar asnjëherë
 - Jo, nuk është e arritshme
33. Kumtesat, politikat dhe dokumentet kyçe të fakultetit a i siguronin në format të arritshëm për studentët tuaj me aftësi të kufizuar? (në vazhdim rrethoni të gjitha pohimet e ofruara që janë të sakta për fakultetin tuaj)
- Po, i sigurojnë në formatin e arritshëm digjital
 - Po, i sigurojnë në formatin e arritshëm zanor
 - Po, i sigurojnë në alfabetin e Brajlit
 - Po, i sigurojnë në format të zmadhuar
 - Jo, i publikojmë vetëm në mënyrë standarde

34. A përdorë fakulteti sistem elektronik për paraqitjen e semestrave/lëndëve/provimeve ngjashëm me iknow?
- Po, përdorim vetëm sistem elektronik për administratë
 - Po, përdorim sistem elektronik për administratë, por me këtë rast është e nevojshme paralelisht të parashtrohet dokumentacioni i njëjtë edhe në formë të letrës
 - Jo, nuk përdorim sistem të tillë, të gjitha dokumentet, regjistrimet dhe vërtetimet janë vetëm me dokumente me letër
- 34.1. A është sistemi elektronik që e përdorni i testuar dhe a keni vërtetim se funksionon për studentë me aftësi të kufizuara?
- Po, e testojmë rregullisht gjatë çdo përditësimi më të madh të tij
 - Po, e kemi testuar vetëm në fillim
 - Jo, nuk e kemi testuar asnjëherë

Ç) Të dhëna për qasjen deri te shërbimet specifike për studentë me aftësi të kufizuar

35. A ka zhvilluar fakulteti së paku një formë të shërbimit specifik për t'u dhënë mbështetje studentëve me aftësi të kufizuar të regjistruar në të, siç janë sigurimi i literaturës profesionale në format të arritshëm, sigurimi i teknologjisë asistive, sigurimi i kohës plotësuese gjatë dhënies së provimit, sigurimi i testit në formatin e arritshëm, sigurimi i personit për marrjen e shënimeve, sigurimi i interpretuesit të shenjave, sigurimi i trajnimit për orientim dhe lëvizshmëri nëpër kampin, etj.)?
- Po, fakulteti ka së paku një person të emëruar të punësuar që u jep mbështetje studentëve me aftësi të kufizuar të regjistruar në të
 - Po, fakulteti ka zyrë/departament/qendër të formuar funksionale për mbështetjen e studenteve në aftësi të kufizuar të regjistruar në të
 - Jo, në fakultetin ka bashkëpunim të lidhur me qendër të jashtme për mbështetjen e studentëve dhe sipas kërkesës së studentit me aftësi të kufizuar fakulteti i siguron këto shërbime përmes atij subjekti të jashtëm
 - Jo, fakulteti nuk ka as person të emëruar, as qendër të formuar funksionale për mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuar, e as, nga ana tjetër, bashkëpunim të lidhur me qendër të jashtme për mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuar

D) Pyetje të lidhura me shërbime specifike që i siguron fakulteti

36. A janë të informuar studentët me aftësi të kufizuara për ekzistimin e shërbimeve specifike me qëllim të studimit të tyre më cilësor në fakultetin tuaj? (Rrethoni pohimet që janë të sakta për fakultetin tuaj)
- Po, i informojnë profesorët dhe të punësuarit tjerë nga kuadri mësimdhënës
 - Po, i informon shërbimi për çështje studentore gjatë regjistrimit në fakultet dhe gjatë studimeve
 - Po, këto informacione janë të arritshme publikisht në ueb-faqen tonë
 - Jo, nuk bëhet promovimi i këtij shërbimi para studentëve me aftësi të kufizuara
37. A ka në fakultetin procedurë dhe person të emëruar përmes të cilit studentët me aftësi të kufizuara mund të kërkojnë nga fakulteti që t'u sigurohet literaturë profesionale e nevojshme për studimin në formatin e arritshëm?
- Po, kemi procedurë të tillë dhe person të emëruar që e siguron këtë shërbim
 - Po, kemi procedurë të tillë, e cila është e automatizuar dhe nuk ka nevojë për emërimin e personit të posaçëm për realizimin e kësaj të drejte
 - Jo, nuk ka procedurë e tillë, e as person të emëruar për këtë shërbim

- 37.1. Në formatin e këtyllë studenti mund ta marrë literaturën profesionale dhe librat shkollorë që nevojiten për studim? (Rrethoni të gjitha pohimet që janë të sakta)
- Në formatin e arritshëm zanor
 - Në formatin e zmadhuar të shtypur
 - Në formatin e arritshëm digjital
 - Në formatin e Brajtit
38. A siguron fakulteti person që merr shënime për ata studentë me aftësi të kufizuar të cilëve u nevojitet përshtatje e tillë?
- Po, në të shumtën e rasteve,
 - Po, por shumë rrallë
 - Jo, asnjëherë
39. A siguron fakulteti teknologji asistive për studentët me aftësi të kufizuar gjatë studimit të tyre në të?
- Po, për të gjithë ata të cilëve u është e nevojshme përshtatja e tillë
 - Po, por jo për të gjithë
 - Jo, nuk siguron

40. A guxojnë studentët me aftësi të kufizuara të përdorin teknologji asistive gjatë ligjëratave?
- Po, guxojnë në të gjitha ligjëratat te të gjithë profesorët
 - Po, por jo në të gjitha ligjëratat dhe te të gjithë profesorët
 - Jo, përdorimi i teknologjisë asistive nuk është i lejuar në fakultet
41. A guxojnë studentët me aftësi të kufizuara të përdorin teknologji asistive gjatë dhënies së provimeve?
- Po, në të gjitha provimet me shkrim
 - Po, por jo në të gjitha lëndët dhe te të gjithë profesorët
 - Jo, gjatë dhënies së provimeve nuk është i lejuar përdorimi i teknologjisë asistive
42. A u mundëson fakulteti kohë plotësuese për dhënien e provimeve atyre studentëve për të cilët kjo është e nevojshme si përshtatje?
- Po, gjithmonë kur kjo përshtatje është e nevojshme
 - Po, por jo gjithmonë dhe të gjithë profesorët e lejojnë atë
 - Jo, kjo përshtatje nuk është e mundur

43. A u siguron fakulteti studentëve me aftësi të kufizuar test në formatin e arritshëm që u nevojitet?
- Po, gjithmonë sigurohen teste në formatin e arritshëm
 - Po, por jo gjithmonë sigurohen teste në formatin e arritshëm
 - Jo, nuk sigurohen teste në formatin e arritshëm
44. A siguron fakulteti hapësirë të veçantë dhe termin plotësues/vazhdim të afatit të provimit për ata studentë me aftësi të kufizuar të cilët kanë nevojë për përshtatje?
- Po, gjithmonë kur kjo është e nevojshme të sigurohet,
 - Po, por jo gjithmonë e siguron këtë përshtatje
 - Jo, asnjëherë nuk e siguron këtë përshtatje
45. A siguron fakulteti interpretues të shenjave për studentët të cilëve u nevojitet përshtatja e tillë gjatë ligjëratave, e veçanërisht gjatë marrjes në pyetje me gojë?
- Po, gjithmonë kur kjo është e nevojshme
 - Po, por jo gjithmonë
 - Jo, asnjëherë nuk sigurohet interpretues i shenjave

46. A siguron fakulteti trajnim për orientim dhe lëvizshmëri me qëllim të lëvizjes së mëvetësishme nëpër kampin dhe objektet e fakultetit për studentët të cilët kanë nevojë për trajnim të tillë?
- Po, gjithmonë kur kjo është e nevojshme
 - Po, por jo gjithmonë
 - Jo, asnjëherë nuk e siguron atë
47. A keni person të emëruar në shërbimin për çështje studentore që duhet t'u asistojë studentëve me aftësi të kufizuara gjatë regjistrimit në fakultet, regjistrimin dhe vërtetimin e semestrit dhe parashtrimin e dokumenteve për diplomim/magjistraturë /doktoraturë etj.?
- Po, kemi person që është i emëruar për asistencë administrativ të studentëve me aftësi të kufizuara
 - Jo, nuk kemi person të emëruar për asistencë administrative të studentëve me aftësi të kufizuara

48. Në çfarë mënyre fakulteti i financon shërbimet e përmendura në pyetjet paraprake? (rrethoni të gjitha pohimet në vazhdim që janë të sakta për fakultetin tuaj)
- Përmes buxhetit personal të fakultetit
 - Përmes buxhetit të universitetit të cilit i përket
 - Përmes buxhetit të MASH-it, MPPS-së dhe organeve të tjera shtetërore
 - Përmes donacioneve nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare
 - Përmes mjeteve personale të studentit me aftësi të kufizuar
 - Përmes donacioneve nga bashkësia e biznesit
 - Në mënyrë tjetër nga ato të lartpërmendura
 - Fakulteti nuk siguron financa, por i përdorë resurset që i ka qendra për mbështetje me të cilën ka lidhur bashkëpunim

DH) Pyetje finale

49. A ka marrë fakulteti në 5 vitet e fundit nga studentët me aftësi të kufizuar ose dikush tjetër në emër të tyre, kërkesë për sigurimin e qasjes/shërbimeve specifike, respektivisht ankesë, kundërshtim, vërejtje, etj. drejtuar fakultetit për shkak të mospajimit të qasjes/shërbimeve specifike?
- Po, ka
 - Jo, nuk ka
 - Nuk kemi përgjigje për këtë pyetje, meqë informacionet e tilla nuk arkivohen /ruhen
50. A planifikon fakulteti, në planet dhe strategjitë e tij zhvillimore t'i ndjekë politikat inkluzive arsimore të shtetit dhe në periudhën e ardhshme t'i përmirësojë kushtet për studentët me aftësi të kufizuar duke mundësuar qasje të përmirësuar dhe shërbime specifike për mbështetje?
- Po, fakulteti planifikon dhe është i gatshëm t'i ndjekë politikat inkluzive arsimore të shtetit dhe t'i përmirësojë të drejtat e studentëve me aftësi të kufizuar
 - Jo, fakulteti nuk është i gatshëm në periudhë të duhur t'i ndjekë politikat inkluzive të shtetit për përmirësimin e qasjes dhe shërbimeve specifike të nevojshme për studentët me aftësi të kufizuar

SHTOJCA 2:

LISTA E FAKULTETEVE QË DORËZUAN PËRGJIGJET E PYETËSORIT

1. Fakulteti juridik – Kërçovë
– Universiteti “Shën. Kliment i Ohrit” në Manastir.
2. Fakulteti për dizajn dhe teknologji të mobiljes dhe enterierit
– Shkup – Universiteti “Shën. Kirili dhe Metodi” në Shkup.
3. Fakulteti i sigurisë – Shkup
– Universiteti “Shën. Kliment i Ohrit” në Manastir.
4. Fakulteti i teknik-teknologjik
– Universiteti “Shën. Kliment i Ohrit” në Manastir.
5. Fakulteti i pedagogjisë “Shën. Kliment i Ohrit” – Shkup
– Universiteti “Shën. Kirili dhe Metodi” në Shkup.
6. Fakulteti i inxhinierisë mekanike – Shkup
– Universiteti “Shën. Kirili dhe Metodi” në Shkup.
7. Fakulteti i arkitekturës – Shkup
– Universiteti “Shën. Kirili dhe Metodi” në Shkup.
8. Fakulteti ekonomik – Shkup
– Universiteti “Shën. Kirili dhe Metodi” në Shkup.
9. Fakulteti i shkencave pyjore, arkitekturës së peizazhit dhe
ekoinxhinierisë “Hans Em”
– Universiteti “Shën. Kirili dhe Metodi” në Shkup.

10. Fakulteti i teknologjive të informacionit dhe komunikimit – Manastir
– Universiteti “Shën. Kliment i Ohrit” në Manastir.
11. Fakulteti për dizajn dhe teknologji të mobiljes dhe enterierit
– Shkup
– Universiteti “Shën. Kirili dhe Metodi” në Shkup.
12. Fakulteti juridik “Justiniani i parë” – Shkup
– Universiteti “Shën. Kirili dhe Metodi” në Shkup.
13. Fakulteti i teknologjisë dhe metalurgjisë – Shkup
– Universiteti “Shën. Kirili dhe Metodi” në Shkup.
14. Fakulteti i stomatologjisë – Shkup
– Universiteti “Shën. Kirili dhe Metodi” në Shkup.
15. Fakulteti teknik – Manastir
– Universiteti “Shën. Kliment i Ohrit” në Manastir.
16. Fakulteti filozofik – shkup
– Universiteti “Shën. Kirili dhe Metodi” në Shkup.
17. Fakulteti i pedagogjisë
– Universiteti “Shën. Kliment i Ohrit” në Manastir.
18. Fakulteti i inxhinierisë elektrike dhe teknologjive të informacionit – Shkup
– Universiteti “Shën. Kirili dhe Metodi” në Shkup.
19. Universiteti i shkencave dhe teknologjive të informacionit
Shën. Apostulli Pali-Ohër

20. Fakulteti i farmacisë
– Universiteti “Shën. Kirili dhe Metodi” në Shkup.
21. Fakulteti i arteve dramatike – Shkup
– Universiteti “Shën. Kirili dhe Metodi” në Shkup.
22. Fakulteti i veterinarisë – Manastir
– Universiteti “Shën. Kliment i Ohrit” në Manastir.
23. Fakulteti i turizmit dhe logjistikës afariste
– Universiteti “Goce Delçev” në Shtip
24. Fakulteti filologjik “Blaze Koneski” – Shkup
– Universiteti “Shën. Kirili dhe Metodi” në Shkup.
25. Fakulteti i informatikës
– Universiteti “Goce Delçev” në Shtip
26. Fakulteti i administrimit të biznesit
– Universiteti “Goce Delçev” në Shtip
27. Fakulteti i kulturës fizike
– Universiteti i Tetovës
28. FAKULTETI I TEKNOLOGJISË USHQIMORE DHE TË
USHQYERIT
– Universiteti i Tetovës
29. Fakulteti ekonomik
– Universiteti i Tetovës

30. Fakulteti i inxhinierisë mekanike – Shkup
– Universiteti “Shën. Kirili dhe Metodi” në Shkup.
31. Fakulteti i shkencave të zbatuara
– Universiteti i Tetovës
32. Fakulteti i bujqësisë dhe bioteknologjisë
– Universiteti i Tetovës
33. Fakulteti i shkencave natyrore dhe të matematikës –
Shkup – Universiteti “Shën. Kirili dhe Metodi” në Shkup.
34. Fakulteti juridik
– Universiteti “Goce Delçev” në Shtip.
35. Fakulteti juridik
– Universiteti i Tetovës
36. Fakulteti i arteve
– Universiteti i Tetovës
37. Fakulteti i shkencave të edukimit
– Universiteti “Goce Delçev” në Shtip.
38. Fakulteti i teknik-teknologjik
– Universiteti “Goce Delçev” në Shtip.
39. Fakulteti pedagogjik
– Universiteti i Tetovës.
40. Fakulteti filozofik
– Universiteti i Tetovës.

SHTOJCA 3:

LISTA E FAKULTETEVE KU ËSHTË KRYER KËQYRJA NË TERREN E QASSHMËRISË FIZIKE

Universiteti "Shën. Kirili dhe Metodi" në Shkup.

1. Fakulteti filozofik në Shkup
2. Fakulteti filologjik "Blaze Koneski" në Shkup
3. Fakulteti juridik "Justiniani i parë" në Shkup.
4. Fakulteti ekonomik në Shkup

Universiteti "Goce Dellçev", në Shtip

1. Fakulteti i shkencave natyrore dhe teknike.
2. Fakulteti i informatikës.
3. Fakulteti i bujqësisë
4. Fakulteti teknik-teknologjik
5. Fakulteti i mjekësisë
6. Fakulteti i inxhinierisë mekanike.
7. Fakulteti i inxhinierisë elektrike.

Universiteti i Tetovës

1. Fakulteti ekonomik.
2. Fakulteti pedagogjik
3. Fakulteti juridik
4. Fakulteti filozofik.
5. Fakulteti filologjik.

Universiteti "Shën. Kliment i Ohrit" në Manastir.

1. Fakulteti pedagogjik.

SHTOJCA 4:

LISTA E ORGANIZATAVE TË INTERVISTUARA TË SHOQËRISË CIVILE DHE ORGANIZATAVE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

1. Polio Plus – lëvizja kundër hendikepit,
2. Organizimi për iniciatiava arsimore dhe kulturore “Hap pas hapi”,
3. Hendikep plus
4. UNDP
5. QRMPAKI-PORAKA
6. Unioni kombëtar i të verbërve të Republikës së Maqedonisë së Veriut
7. Unioni kombëtar i personave me invaliditet trupor “Mobiliteti - Maqedoni”
8. Kooperativa Bravura
9. Shoqata e studentëve me hendikep

